

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7688 E mërkurë 24 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* Ditës

Admirali William H. Meraven, veteran i flotës detare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe autor i librit "Nëse doni të ndryshoni botën..." beson ...
Vijon në faqen 12

Nga VALBONA NATHANAILI

Në barkun e balenës



Opinion *i* Ditës

Është e thjeshtë të pohosh pse dhe si ndodhi në 1956-n në Hungari. Pse ndërhyjnë sovjetikët me forcën e armëve, si u vranë njerëz, si u shtyp revolta dhe ...
Vijon në faqet 20-21

Nga PËRPARIM KABO

Hungari 1956, si vijoi historia...



Edi Rama: Kemi gati 12 padi për shpifje

Basha në prokurori: Balla dhe 2 deputetë të tjerë pas 'Toyotës' me 3.4 milionë euro

Kryetari i PD përmend Ulsi Manjën dhe Jurgis Çyrbjan. Shpifja, Veliaj fiton gjyqin ndaj PD

VALENTINA MADANI

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, u thirr dje në Prokurorinë e Tiranës për të dëshmuar në lidhje me një hetim të nisur ndaj tij për nxjerrje të sekretit shtetëror për çështjen e "Toyota Yaris"-it. Prokuroria e Tiranës ka nisur ...
Në faqen 4

SUPER-OPERACIONI/ ZBARDHEN PERGJIMET E FAMILJAREVE TE ARBEN NDOKES

POLICIA: 300 TE ARRESTUAR. JA ROLI I DEA-S AMERIKANE

Ardi Veliu: Goditëm 4 grupe kriminale, kapëm 44 armë. "Zëri i Amerikës": U kapën 183 kg morfinë, ndihmuan amerikanët, gjermanët dhe partnerë të tjerë



(Në foto) Drejtori i Pergjithshëm Ardi Veliu, dje gjatë konferencës për mediat

VENDIMI

PS në Komisionin e Ekonomisë mbyll lojërat e fatit, Rama: Faleminderit
Në faqen 7

KRYETARJA E LSI

Kryemadhi: Aksioni i policisë, sinjal i mirë. PS u kthye në sekt kriminal
Në faqen 4

KRYESIA E PS

Emrat e 11 krerëve të PS-së në rrethe që propozohen për t'u shkarkuar
Në faqen 6

"VIP PAGES"

Balerina Jora Hodo: Sfidë ime e madhe, larg familjes dhe dashurisë
Suplement

REKTORI: JEPNI DREJTESI



Studentët e "Luarasit", vizitë në paraburgimin e 313 në Tiranë
Në faqen 17

Franceskanët zbulojnë çfarë shkruante nga Roma frati i shquar në vitin 1925

Pesë letrat e panjohura të Gjergj Fishtës

Komunikimet për "Lahutën" dhe kërkesat e vazhdueshme për duhan e raki

NGA FATMIRA NIKOLLI

Si të thashë, kam filluar një këngë, që shpresoj se ka me mbetë nder më të bukura të Lahutës. Dër m'sod kam shkruar ktu n'Itali kater këngë të Lahutës; një Canticco drammatico më se dy mij vjerrshash; një Konferencë



mbi Provincjen t'onë e një satirë mjaft të gjatë. E pra Doktor i më ka pasë urdhnuar kater muej pushim menduer, posë trazimesh të mëdha që më qesin letrat shum herë të papuna. I falem nderës Zotit, që kë kthye në Shkodër t'!". Pesë letra të At Gjergj Fishtës janë ...
Në faqet 18-19

OPERACIONI I POLICISE HETIMET

Operacioni "Vol-Vo 4", Ardi Veliu: U goditën 4 grupe kriminale

"Forca e Ligjit", kreu i policisë: Arrestuam 300 veta që nga shtatori

"U sekuestruan 43 armë zjarri dhe automjete"

TIRANE

Përmes një deklarate për mediat, drejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu tha se që prej datës 20 shtator të këtij viti, me urdhër të kryeministrit Edi Rama dhe ministrit Fatmir Xhafaj ka nisur një operacion në të gjithë vendin i koduar "Ndëshkimi i të fortëve".

Veliu u shpreh se operacioni "Ndëshkimi i të fortëve" identifikon dhe ndëshkon individët, që në shkëlqje të ligjit cenojnë rendin e qetësinë publike dhe guxojnë të sfidojnë autoritetin e shtetit dhe forcën e ligjit. Sipas Veliu, që nga nisja e këtij operacioni në shtator janë arrestuar mbi 300 persona.

DEKLARATA E PLOTE KREUT TE POLICISE

Policia e Shtetit në bashkëpunim me agjencitë e tjera ligjzbatuese dhe me mbështetje aktive nga partnerët ndërkombëtarë është e angazhuar në luftë të pakompromis për parandalimin, identifikimin dhe goditjen e individëve të përfshirë në veprimtari kriminale dhe veçanërisht krimi të organizuar dhe grupeve kriminale në vend. Operacioni "Forca e Ligjit", iniciuar vetëm 11 muaj më parë ka rezultuar një nisim e suksesshme e qeverisë, Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, për përballjen me drejtësinë të drejtuesve dhe anëtarëve të këtyre grupeve kriminale. Që prej nëntorit 2017, kur nisi operacioni "Forca e Ligjit" përsëritim, identifikimin dhe hetimin, një sërë grupeve kriminale janë goditur dhe një numër i konsiderueshëm i anëtarëve të këtyre grupeve sot janë pas hekurave të burgut. Operacioni i orëve të fundit "Vol-Vo 4" goditi anëtarët e 4 grupeve kriminale dhe pati një shtrirje në 12 qytete, pa asnjë dekonspirim, me gjithë përmasat jo të zakonshme të një operacioni policor, me 1500 efektive në terren. Për shumë grupe të tjera të sked-



Drejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu

REZULTATET E OPERACIONIT

- Rreth 160 persona të identifikuar me precedentë apo prishës të rendit, të konsideruar si 'të fortë' janë ndaluar apo arrestuar, ndër ta rreth 70 vetë për armëmbajtje pa leje.
- Gjithashtu janë kapur e arrestuar 154 persona, për të cilët ka pasur një urdhër kërkimi kombëtar dhe 14 të tjerë në kërkim ndërkombëtar, për vepra të ndryshme penale.

uara, tashmë në hetimet intensive prej shumë muajsh, janë në rrugë të mbarë dhe do të ketë shpejt të tjera rezultate domethënëse në këtë luftë pa kompromis.

Sot jam përballë jush dhe qytetarëve, për t'ju informuar dhe bëri me dije rezultatet e para të një tjetër operacioni me shumë rëndësi, në të cilin është angazhuar Policia e Shtetit në të gjithë territorin e vendit. Që nga mesi i muajit shtator në zbatim të një porositë të kryeministrit të vendit dhe me urdhër të Ministrit të Brendshëm, Poli-

cia e Shtetit programoi zhvillimin e një operacioni kontrolli, parandalimi dhe ndëshkimi në territor. Nga Drejtoritë Vendore të Policisë së Qarqeve fillimisht u hartuan lista nga çdo Komisariat dhe Zonë Policore, individët me precedentë kriminal, me rreziqshmëri shoqërore si dhe individët problematikë me sjelljet e tyre të dhunshme në mjediset tona shoqërore.

Ky operacion synon qartësisht:

- Të parandalojë veprimtaritë kriminale në territor,

APELI I ARDI VELIUT

"Policia e Shtetit u bën apel qytetarëve të kontribuojnë për rritjen e parametrave të sigurisë, mbrojtjen e rendit, qetësinë publike, respektimin e ligjit nga të gjithë për vendosjen e autoritetit të shtetit. Kjo duke njoftuar strukturat në numrin 112", deklaroi dje drejtori i Përgjithshëm i Policisë.



Policia gjatë arrestimeve të operacioni "Vol-Vo 4"

dari emrash të hollësishtëm, kudo që ata ndodhen dhe nuk i pret ata në postbllok apo t'i ndalohë kur përfshihen në ngjarje kriminale. Nga data 20 shtator Drejtoritë Vendore të Policisë, Forcat Operacionale, FNSH, e posaçërisht forcat RENE A sipas një plan veprimi të detajuar janë angazhuar gjerësisht në territor në realizimin e operacionit policor të koduar "Ndëshkimi i Të fortëve". Të gjithë këtë aktivitet të shtirë në çdo skaj të vendit gjatë kësaj periudhe e kemi zhvilluar qëllimisht në heshtje publike, duke pasur interes të parë rezultatet. Sot jemi këtu pikërisht për t'ju bërë me dije rezultatet më të rëndësishme konkrete të javëve të para të cilat janë premtuese, çka do të thotë se operacioni do të jetë i suksesshëm edhe në etapën e mëtejshme. Tani ju ftoj në ekranin krahe me të ndjekim 2 video të shkurtra, që prezantojnë shkurt dhe me pamje, pjesë nga puna e forcave policore në territor gjatë Operacionit policor "Ndëshkimi i Të fortëve".

Më konkretisht, gjatë veprimit të Forcës së Ligjit në territor në kuadrin e Operacionit policor "Ndëshkimi i Të fortëve", nga strukturat vendore të policisë janë kryer kontrole për personat me precedentë kriminal aktiv, personat në kërkim dhe personat si prishës sistematik të rendit publik. Këto janë disa nga rezultatet në tregues konkret, gjatë këtyre javëve të veprimit të operacionit në territor. Janë arrestuar vetëm në kuadrin e këtij operacioni, mbi 300 persona në kontroll për aktive në territor, ndër ta:

o Rreth 160 persona të identifikuar me precedentë

apo prishës të rendit, të konsideruar si 'të fortë' janë ndaluar apo arrestuar, ndër ta rreth 70 vetë për armëmbajtje pa leje.

o Gjithashtu janë kapur e arrestuar 154 persona për të cilët ka pasur një urdhër kërkimi kombëtar dhe 14 të tjerë në kërkim ndërkombëtar, për vepra të ndryshme penale. Ndër provat e sekuestruara gjatë kontroleve të ushtruara ndaj tyre në akset rrugore, bane, lokale etj. Janë sekuestruar 43 armë zjarri të llojeve të ndryshme, automjete dhe një sasi e konsiderueshme parash. Policia e Shtetit, duke përfutur nga rasti kërkon ndjesë, nëse në ndonjë rast kontrolet e ushtruara në ambiente publike krijojnë shqetësim, por e konsiderojmë më shumë rëndësi vënien para përgjegjësisë ligjore të personave që tentojnë të sfidojnë autoritetin e shtetit, nën petkun e "të fortit".

Nuk ka të fortë përballë autoritetit të ligjit!

"Forca e Ligjit në Territor" përmes operacionit policor "Ndëshkimi i Të fortëve" nuk do të ndalet këtu, por do të vijojë ditë pas dite, javë pas javë, duke ndëshkuar ashpër me autoritetin dhe forcën e ligjit çdo individ shkelës të ligjit dhe sfidues të autoritetit të shtetit që do të guxojë të cenojë jetëshën normale të qytetarëve, rendin e qetësinë publike. Në ditët e ardhshme Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit do të prezantojnë një paketë masash të forta ligjore, administrative e operacionale për parandalimin dhe ndëshkimin e krimi në territor në funksion të rendit e sigurisë publike dhe një marrëdhënie të re midis policisë dhe komunitetit.



Nga transkriptimi i përgjimeve në dosjen e prokurorisë, rezultojnë se ka nisur një konflikt i rëndë nga anëtarët e familjes Ndoka, kjo për një pronë bregdetare me një sipërfaqe prej 4500-5000 m². Nga të dhënat e përfuara gjatë hetimeve rezultojnë se pronar de facto ka qenë Arben Ndoka, i cili kishte idenë se edhe juridikisht do të ishte kaluar në emër të tij nga anëtarët e familjes.

Shtetasi Arben Ndoka rezultojnë se ka konstatuar se pronar e tij nuk figuronte në emrin e tij, por në emrin e shtetasisit Altin Mikaj, ku ka të dhëna se është dhëndër i të ndjerit Sandër Ndoka. Pas ardhjes në dritën e këtij momenti, Arben Ndoka është acaruar dhe ka pasur debate të forta me motrën e tij, Mimoza Ndoka dhe vëllain e tij, Gjevi Ndoka. Në përgjimet në vijim rezultojnë se Arben Ndoka duke pasur idenë se anëtarët e tij të familjes kishin dalë nga rregullat 'kanunore' familjare, është acaruar dhe ka akuzuar vëllain më të madh, të ndjerin Aleksandër Ndoka. Duke qenë se pronën që realisht duhet të ishte në emër të tij i është dhënë pa ndonjë shpjegim dhëndërit të Aleksandrit. Kujtojmë se shtetasi Aleksandër Ndoka, vëllai i ish-deputetit PS, mbeti i vrarë me armë zjarri më 9 dhjetor të 2017.

"Balkanweb" shkruan se Arben Ndoka ka kërkuar llogari si nga familjarët e tij, ashtu edhe nga punonjësit në zyrat përkatëse shtetërore që prona objekt konflikti duhej kthyer me patjetër në pronë shtet, pastaj e dinte ai se si të vepronte për ta marrë. Kështu ai debatonte me Gjevi Ndokën, Mimoza Ndokën, Bardhok Bardhi, inxhinier dhe Bledar Cara kushëri i tyre që punon në hipotekë. Në vijim tregohet shqetësimi që kishte sidomos Mimoza dhe Gjevi pasi kishin frikën e ndonjë përplasjeje fizike ndërmjet vëllezërve Aleksandër dhe Arben Ndoka.

PJESË NGA PËRGJIMET

Mimoza: Tashti që ta dish se prandaj i karëni telefonit... që të lidhesh me Bardhin dhe të marrësh numrin e parcelës që ta verifikosh... A po lidhesh me Bardhin ti? (Bardhok Bardhi rezultojnë inxhinier gjeodezie matje).

Gjevi: Shih tani Moze që ta shpjegoj unë një diçka... kur futesh te Pashku e del tek ajo rruga për me dal e u la (plazhi). Ky e ka djathtas e Pashku e ka majtas Moze, nuk ka lidhje fare!


Hetimi për abuzimet, ish-deputeti i PS debatonte me motrën dhe vëllain

Përgjimet e Arben Ndokës, përplasje me familjarët për tokat në bregdet

Prokuroria: Kërkoj që të kthehej në "pronë shtet"



Arben Ndoka



Faksimil i përgjimeve të Arben Ndokës

BESFORT LAMALLARI



Flet zv.ministri i Brendshëm: Operacioni nuk u dekonspirua

Zëvendësministri i Brendshëm, Besfort Lamallari ka hedhur dje poshtë zërat se operacioni për arrestimin e 27 personave gjatë aksioneve në fundjavë në disa rrethe të vendit u dekonspirua. Lamallari tha se të angazhuar në terren ishin rreth 1200 punonjës policie, ndërsa shtoi se hetimet u kryen në bashkëpunim edhe me partnerët e tjerë ndërkombëtarë. Teksa u pyet në lidhje me faktin nëse do të ketë apo jo arrestime të tjera, zv.ministri i Brendshëm tha se operacioni për goditjen e grupeve kriminale dhe të "të fortëve" do të vijojnë.

"Nuk ka pasur dekonspirim të operacionit. Ka pasur përfshirje masive të Policisë së Shtetit. 1200 oficerë janë përfshirë, janë kryer mbi 1000 kontrolle. Çështje të tilla kanë vend për mbledhje provash", tha Lamallari për "News24".

Në Has u gjetën 182.5 kg morfina të ndara në 175 pako

"Zëri i Amerikës": Operacioni i policisë, ndihmoi Antidroga amerikane dhe gjermanët



KERKESAT E BE
Lufta kundër kriminit të organizuar dhe korrupsionit është një nga kërkesat kryesore të Bashkimit Europian para se të mund të hapen negociatat me Shqipërinë për anëtarësim të plotë.

me dije se përkrah policisë shqiptare në këtë operacion dhe hetimeve dyvjeçare kanë qëndruar edhe ekspertët e agjencive të Antidrogës amerikane, gjermane dhe shtete tjera të prekura nga kjo veprimtari kriminale. Ata provuan së bashku 13 episode me lëndë narkotike dhe sende të tjera antiligjore të pjesëtarëve të këtyre grupeve kriminale që nga Lezha, Durrësi, Shkodra, Burreli, Saranda, Lushnja, Kukësi e deri në Itali. Pika kulmore e operacionit, krahas arrestimeve në qendrrin

e tyre në Shijak, ishte zbulimi dhe goditja e laboratorit të përpunimit të drogave të forta në Has, ku u gjetën 182.5 kg morfina, e ndarë në 175 pako, 22 litra lëndë e lëngshme, të cilat përdoreshin për prodhimin e heroinës. Materialet vinin nga Turqia përmes Kosovës dhe pas përpunimit në Has, zbritnin në qytetet bregdetare për t'u nisur drejt Italisë. Po inxhinierët shprehu mosbesimin e saj mbi këto operacione. Përfaqësues të saj pohuan se qeveria dhe policia është e lidhur me drejtues të grupeve

ve kriminale dhe nuk i arreston ata edhe kur ua tregojnë policitë e shteteve partnere. Deputeti i Partisë Demokratike, Enkelejd Alibeaj tha se, "policia është bërë vegël e propagandës së Edi Ramës, sepse në listën me të ashtuquajtur 300 të fortë nuk ka asnjë emër kriminel, që drejton realisht bandat në vend. 'Forca e Ligjit' nuk ekziston, sa kohë që asnjë bos i kriminit nuk është arrestuar dhe asnjë pasuri e bosëve të kriminit nuk është sekuestruar.

Mimoza: Bravo... mirë shumë bukur shyqyr aq ma mirë.

Gjevi: A kupto?! Nda rru... ka shenjë në të... rri e qetë e di unë atë punë.

Mimoza: Po, po, perfekt ndërkohë ti vetëm sqaro Bardhin...

Gjevi: Po në pastë merak, po ta them me bindje se dikund aty e din ai se jam

edhe unë me këtë... e ia jap unë pjesën teme e s'ma bahet vonë hiç!

Mimoza: Po jo ore se nuk është ashtu, nuk don ashtu ai...!

Gjevi: Nuk e lo po gjo unë të mos mërzitet ai!

Mimoza: Jo, ju nuk ka lidhje kjo pjesë... ai! thjesht don që mos të jenë hap 'njëzë' e vet aty! Kët hall ka ai.

DREJTËSIA REAGIMET

Valentina Madani

"Toyota Yaris", kreu i PD thirret në prokurori: Lidhjet qeveri-krim, si sekret shtetëror

Basha: Përveç Ballës, edhe dy deputetë PS në aferën e milionave

"Të përfshirë edhe Ulsi Manja e Jurgis Çyrbja"

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, u thirr dje në Prokurorinë e Tiranës për të dëshmuar në lidhje me një hetim të nisur ndaj tij për nxjerrje të sekretit shtetëror për çështjen e "Toyota Yaris"-it. Prokuroria e Tiranës ka nisur një hetim paralel me atë të Krimeve të Rënda për çështjen "Toyota Yaris", ndaj Basha për më shumë se 20 minuta dha detaje për ngjarjen. "Prokuroria ka kërkuar dëshminë time për hetimin që ka hapur në lidhje me nxjerrjen e sekretit shtetëror sa i përket veprës kriminale të futjes së parave të kimit me "Toyota Yaris". Ky veprim dëshmon se deklaratat e mia publike, denoncimet e mia publike për përfshirjen e Taulant Ballës në dhënien e garancive politike dhe në trafikimin e paligjshëm të parave të pista të kimit janë të vërteta", u shpreh kreu i PD-së. Z.Basha në derën e prokurorisë akuzoi se në këtë çështje përveç Ballës, janë përfshirë edhe dy deputetë të tjerë, Ulsi Manja dhe Jurgis Çyrbja. "E kapur nga pushteti kriminal i Edi Ramës dhe nga krimi, prokuroria po i trajton lidhjet e pushtetarëve me krimin si sekret shtetëror. Po mbron lidhjet e Taulant Ballës me bandat e kriminit të organizuar, lidhjet e Vangjush Dakos me bandat e kriminit të organizuar me bandat e kriminit të organizuar, si sekret shtetëror. Në vend që të hetojë se kush qëndron prapa transaksioneve kriminale të miliona eurove me "Toyota Yaris", në vend që të hetojë se kush i garanton këto akte të rënda kriminale, po e trajton këtë si një nxjerrje të sekretit shtetëror", deklaroi z.Basha. Krahas Taulant Ballës, Lulzim Basha deklaroi se në aferën e "Toyota Yaris"-it janë të përfshirë edhe dy deputetë të tjerë socialistë. "Në këtë aferë janë të përfshirë edhe dy deputetë të tjerë të Partisë Socialiste, Ulsi Manja dhe Jurgis Çyrbja", u shpreh kreu i PD-së. Provat që disponon prokuroria, Basha shprehet se janë të mjaftueshme për arrestimin e Taulant Ballës dhe zyrtarëve të lartë të Partisë Socialiste, të përfshirë në afera kriminale. "Nëse prokuroria do të vepronte mbi përgjimet zyrtare, faktet dhe provat që disponon, sot Taulant Balla duhet të ishte në arrest. Vangjush Dako duhet të ishte në arrest.

Saimir Tahiri, Qazim Sejdi ni duhet të kishin një prencencë me dekada burg. Fatmir Xhafaj do të ishte jashtë politikës", deklaroi kreu i

opozitës. Çështja e "Toyota Yaris"-it u denoncua nga Lulzim Basha në seancën plenare të 21 qershorit, ndërsa pak ditë më vonë gjatë një

akcioni të policisë në Portin e Durrësit në dy automjete u sekuestruan 3.4 milionë euro. Basha akuzoi Taulant Ballën si garant të parave,

ndërsa tha se ato i përkisnin një ndër grupeve më të rrezikshme kriminale të Elbasanit. Për nxjerrje të sekretit hetimor, kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, është paditur në muajin qershor në Prokurorinë e Krimeve të Rënda nga kreu i grupit parlamentar të socialistëve, Taulant Balla. "Njëri prej atyre që zgërdhiet me shumë ka qenë në Gjermani para tri ditësh. Mbajeni mend këtë që po ju them dhe ka porositur një "Toyota Yaris", po ta kanë zbuluar "Toyota"-n o zgërdhimitar, bashkë me 1.5 milionë euro të drogës brenda". Kjo deklaratë e Bashës në foltoren e Kuvendit është bërë shkak që Prokuroria e Tiranës të nisë një hetim për nxjerrjen e sekretit hetimor.



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

DEKLARATA

Krahas Taulant Ballës, Lulzim Basha deklaroi se në aferën e "Toyota Yaris"-it janë të përfshirë edhe dy deputetë të tjerë socialistë. "Në këtë aferë janë të përfshirë edhe dy deputetë të tjerë të Partisë Socialiste, Ulsi Manja dhe Jurgis Çyrbja", u shpreh kreu i PD-së.



Gjatë një seance parlamentare

MESAZHI



Berisha: Rama, me rezidencë në Nju Jork

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje një mesazh të qytetarit dixhital, bashkëngjitur një foto ku thuhet se është rezidenca që po ndërton kreu i qeverisë shqiptare, Edi Rama në State Island, Nju Jork. "Shtëpia po ndërtohet e re dhe është pranë shtëpisë si Selim Rusit, një emër i njohur në Shqipëri, por edhe si person që ka njohje të afërt me Ramën. Selim Rusi është një biznesmen i njohur edhe në qarqet amerikane, por edhe shumë miqësor me kryeministrin shqiptar, demonstruar kjo nga foto të shumta që gjenden lehtë edhe në rrjetet sociale", thuhet në mesazhin dërguar ish-kryeministrin Berisha.

Kryetarja e LSI: PS është kthyer në sekt kriminal

Aksioni i policisë, Kryemadhi: Sinjal i mirë, por skepticizmi te drejtësia

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi akuzoi dje se kryeministri Edi Rama gjatë këtyre viteve qeverisë ka instaluar në vend krimin. Në një takim me të rinjtë e Vlorës, Kryemadhi deklaroi se Partia Socialiste është kthyer në sekt kriminal. "Çdo ditë dhe më shumë mundësitë për të rinjtë bëhen të pakta. Historia sa ka nisur. Në këto vite që qeverisi Rama, instaloi krimin. Vetëm përballë të rinjve, përballë shpresës, nuk mund t'i bëjë dot rezistencë njeri. Kam besim te të rinjtë. Ne sot kemi një PS që është kthyer në sekt kriminal dhe nuk është vetëm parti, ndaj du-



het të punoni shumë fort, si të rinjtë e Vlorës. Çdo angazhimi i juaj do të jetë i rëndësishëm për ju dhe qytetin", - deklaroi kryetarja e LSI, Kryemadhi e cilësoi "një sinjal të mirë", aksionin e fundit të policisë, që goditi

anëtarë nga katër grupe kriminale. "Është një sinjal i mirë, sepse të ndalosh sot grupe kriminale apo të zbulosh laboratorë droge, të cilët në një farë mënyre kanë njohësor të ardhmen e Shqipërisë, apo emrin e Shqipërisë në hartën e Europës, është diçka që fillon t'i lëvizë gjërat, por nga ana tjetër skepticizmi, jo vetëm i klasës politike, por edhe skepticizmi i njerëzve është se sa të qëndrueshme do të jenë institucionet e drejtësisë për të përballuar presionet e këtyre grupeve dhe bandave kriminale, të cilat janë arrestuar", është shprehur Kryemadhi gjatë një takimi me strukturat e LRI, Vlorë.

STRATI
Shoqëria përmbarimore "STRATI BAIILOFFS SERVICE" Sh.p.k.,
njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

- "Dyqan", me sipërfaqe 60 m², ndodhur në Rruga e Durrësit, Tiranë, Zona Kadestrale 8310, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 518, datë 13.03.2007, në pronësi të Shoqërisë "LIM-EM" sh.p.k, lënë si garanci hipotekore për Bankën Tiranë sh.a me Kontratë Hipotekore Nr. 1201 Rep., Nr. 800/3 Kol., datë 13.03.2008. Çmimi fillestar i ankandit është 48,082 Euro.
*Ankandi për pasurinë e mësipërme zhvillohet në datë 31.10.2018.

Ankandi për pasurinë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

ZYRA PERMBARIMIT GJYQESOR KORCE

1-Me date 01.11.2018, ditën e Enjte ora 16.00 fundon ankandi i pare per pasurine: (Aparament) me nr.pasurie 4/267+1-2.zk.8662,vol.1,Iq.227 me sipërfaqe prej 52 m² regjistruar në Z.V.R.P.P. Korce , e ndodhur në adresen Lagjia nr.4,Rr."Todi Vogli"pallati nr.4,Shk.a,K.4,Korce

2-Cmimi fillestar me te cilin fillon ankandi eshte 1.360.000 ,leke.

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Zyres se Permbarimit Korce Me adrese Bulevard "Republika" Keshilli Qarkut,Kati 4, Korce tel.082245621



SHKURTE

Ulsi Manja padit Bashën: Do ta lag gurmazin

Lulzim Basha duhet të përballlet edhe me një tjetër paditë për shpifje. Është kryetari i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja ai që ka reaguar dhe menjëherë pasi kryedemokrati e bëri atë pjesë e të grupit të deputetëve që kanë lidhje me çështjen trafikut të drogës ose, siç njihet ndryshe, çështja "Toyota Yaris". Nëpërmjet një statusi në rrjetet sociale, Manja ka bërë të ditur se për deklaratat e bëra nga Basha duke dalë nga prokuroria, do të paditet për shpifje. "Me shumë kënaqësi, së bashku me kolegun do t'i bashkëngjitemi Taulantit në rrugën drejt gjyqit me Lulzim, ku do t'i kërkojmë këtij djali të llastuar dhe qafir, një sasi të hollash për shpifje për shkak të detyrës!", shkroi Manja. I bindur se do të fitojë në këtë betejë juridike me kreun e PD-së, Manja e ka paralajmëruar atë se do të duhet të vërtetohet akuzat e bëra kundrejt tij. "Kur të të vijë dita të japësh llogarinë tënde para një prokurori, më ke në dispozicion për asistencë kundër tharjes së gurmazit. Si prokuror i hershëm që jam, ua kam lag fytyrën shumë bilbilave si puna jote kur u ka ardhë siraja për t'i ulur në karrigen e hetimit", nënvizoi Manja.

Vasili: Fundi i Ramës, i njëjtë më atë të diktaturës

Kreu i deputetëve të LSI, Petrit Vasili e cilësoi një shtetin tradhtar dhe hajdut, i cili sipas tij ua jep të huajve detin dhe tokën. Po ashtu ai komentoi edhe vendimin e djeshëm të Gjykatës së Tiranës, e cila dënoi për shpifje me 1 milion lekë këshilltarin e PD për Bashkinë e Tiranës, pasi ky i fundit akuzonte Erion Veliajn. "Shtet që jua shtet, si tradhtarët më të zinj, vendin të huajve me det e tokë e me ç'tu ndodhet. Shtet që procedon kryetarin e opozitës dhe mbyll çdo proces të kryeministrit. Prokurori që i shërben për të asgjësuar "grupet armiqësore brenda partisë". Shtet që dënon një këshilltar opozitar se denoncon mashtrimin dhe premtimet mashtruese publike të një gënjeshтари të pacipë në krye të bashkisë. Shtet që rëmben e dhuron studentët se i thonë kryeministrit hapur që po i plaçkit me taksat. Shtet i mbushur me kusarë e grabitqarë që kanë dalë sheshit dhe si hienat po shqyjnë njëri-tjetrin. Ky shtet është edhe me i zi se ai përpara viteve '90, por fundi është i njëjtë, njësoj i tmerrshëm dhe shumë i afërt...dhe i pashmangshëm", shprehet z.Vasili.

Inaugurohet "Fondi i Edukimit", gjykata dënon këshilltarin demokrat për shpifje

Rama: Gati 12 padi antishpifje, opozita do lërë çizmet gjyqeve

"Burgjet do monitorohen me kamera"

Nërsa paketa antishpifje nuk është publikuar ende nga qeveria, mazhoranca ka arritur fitoren e parë në këtë drejtim. Lajmin e ka dhënë vetë kryeministri, Edi Rama, i cili bëri të ditur se gjykata ka dhënë vendimin e parë që dënon shpifjen e politikanëve shqiptarë. Ai i është referuar pikërisht vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila shpalli fajtor për veprën e shpifjes këshilltarin demokrat të Këshillit Bashkiak të Tiranës, Akl Kraja, për disa deklarata që ai kishte bërë më parë kundrejt kryebashkiakut, Erion Veliaj. Sipas këtij vendimi, Kraja detyrohet t'i paguajë një dëmshpërblim moral prej 1 milion lekësh kryetarit të Bashkisë së Tiranës. Gjëbë kjo që sipas Ramës do të shkojë për "Fondin e Edukimit", që synohet të krijojë të ardhura nga të gjithë politikanët dhe individët e tjerë që do të dënohen me vendim gjykate për veprën e shpifjes. "Inaugurohet Fondi i Edukimit nga një shpifje e PD për @erionveliaj? Kontributi i parë për një bibliotekë shkollë në Kodër-Kamzë", shkroi Rama në rrjetin social "Twitter". Por ai paralajmëron se ky është vetëm fillimi i një serie padish për shpifje që do të bëjnë përfaqësuesit socialistë kundrejt çdokujt që do të bëjë apo shkruajë deklarata që nuk arrijnë dot të faktuojë vërtetësinë e tyre. Dhe për këtë ai do të japë vetë i pari shembullin duke dorëzuar në prokurori plot 12 padi për shpifje, ndërsa një numër tjetër i madh padish janë duke u përgatitur. Madje me ironi, kryeministri tha se për të paguar të gjitha detyrimet që do të lindin nga këto vendime gjyqësore për shpifje, opozita do lërë dhe çizmet gjyqeve. "Gati 12 paditë e para antishpifje nga ana ime. Në përpunim nja dy duzina të tjera. Kjo opozitë si Liza në botën e çudirave do lërë dhe çizmet gjyqeve", shkruan Rama.

PORTALET

Kryeministri Rama ka paralajmëruar disa ditë më parë marrjen e masave që sipas tij, do të ndalojnë deklaratat dhe akuzat e pabazuara jo vetëm të politikanëve, por edhe medias. Ndërkohë që pjesë e kësaj pakete që po harton mazhoranca qeverisëse është edhe



Kryeministri, Edi Rama

Veliaj: PD e ka kthyer shpifjen në zanat

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj gjatë një takimi me banorët e Njësisë Nr.3 komentoi vendimin e gjykatës, e cila dënoi dje një prej këshilltarëve demokratë për akuzën e shpifjes. Veliaj akuzoi PD-në se e ka kthyer shpifjen në profesion më vete. "Ne sapo fituam një gjyq me PD-në ku gjykata e Tiranës dënoi për shpifje një parti që shpifjen e ka kthyer në hobi, shpifjen e ka kthyer në zanat, në profesion dhe ashtu, siç u la porosi nga kryetari i PS-së, të gjitha paratë e fituara nga shpifjet, nga gjyqet për shpifje do të shkojnë në të sjellë më shumë kompjuterë, libra dhe materiale didaktike në shkollat tona. Unë kam vendosur që me një milion lekë të vjetra, aq sa kishim kërkuar për shpifjen, në Gjykatën e Tiranës ndaj PD, nesër do i bëj dhuratë dy kompjuterë për shkollën "Isa Boletini", tha Veliaj. Kreu i Bashkisë u kërkoi banorëve të Njësisë Nr. 3 që të japin një mbështetje maksimale për PS-në në zgjedhjet e ardhshme, që në këshillin bashkiak të jenë anëtarë që punojnë për qytetin dhe jo që shpifin. "Pyetja që kam për PD-në është se për çfarë i çoni, kanë 3 vjet që nuk vijmë edhe njëherë që vijmë shpifin edhe dënohen. Për çfarë vijmë në këshillin bashkiak?", deklaroi Veliaj.



vendosja e një regjimi të rreptë edhe për të gjitha portalet që funksionojnë në Shqipëri. "Nga diskutimi për paketën antishpifje del qartë se urbanizimi i xhunglës online nis nga legalizimi i portaleve. Legalizimi mund të bëhet në pak minuta përmes regjistrimit online në QKB", ka bërë të ditur më parë Rama. Nisma e

qeverisëse për të vendosur këtë regjim të ri për mediat online shqetësoi para pak ditësh edhe OSBE-në, e cila nëpërmjet përfaqësuesit të saj, Harlem Désir deklaroi se nuk mund të ketë imponim të regjistrimit të portaleve. "Shtetet nuk duhet të imponojnë regjistrimin e detyrueshëm për mediat online si parakusht për punën

ÇYRBJA

Ashtu si edhe Ulsi Manja, edhe deputeti tjetër socialist, Jurgys Çyrbja ka paralajmëruar Lulzim Bashën se do të përballlet në prokurori me një tjetër padi për shpifje. "E sfida Lulzim Bashën të përballlet me mua në gjykatë me prova e fakte, jo vetëm për këtë akuzë po për gjithçka këto muaj ka hedhur drejt personit timi", tha Çyrbja. Basha e akuzoi Çyrbjen se kishin lidhje me 3 milionë eurot e kapura në Toyota Auris.

e tyre, gjë që mund të ketë efekt shumë negativ në lirinë e medias. Kjo praktikë, kur vihet në zbatim, mund të kufizojë ndjeshëm aksesin e publikut në burime të larmishme informacioni dhe pluralizimin e zërave, si edhe gërryen të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të informimit online", deklaroi Désir. Por vetë kryeministri gjatë një bisede me të u përpoq të qartësojë propozimin e tij, ndërsa bëri të ditur se shumë shpejt platforma antishpifje do të hidhet për diskutim në publik me gjithë aktorët e interesit.

BURGJET

Kryeministri ishte i pranishëm dje edhe në ceremoninë e prezantimit të drejtorit të ri të Policisë së Burgeve, Bardhyl Kaçori. Para drejtorëve të policisë së Burgeve në rrethe, Rama tha se në të gjitha burgjet do të vendosen kamera, të cilat do të monitorojnë të dënuarit me rekorde kriminale. "Aktivitetet e jashtëligjshme dhe korruptive nuk duhet të ekzistojnë më. Kush bashkëpunon për çdo arsye me elementët kriminalë për vuajtjen e dënimit, duke vënë në pikëpyetje institucionin, do të nëndshkohet pa asnjë rezervë. Rregullorja do të jetë precize dhe do të ketë kamera 24 orë, duke filluar që nga burgu 313 e më pas në të 24 institucionet e tjera. Kamerat nuk do shihen vetëm nga Drejtoria e Burgeve, por dhe operacioni "Forca e Ligjit", pra do të ketë dy salla monitoruese 24 orë, që askush mos fshihet nga batanija që i hedh kamerave", tha Rama.

KRYESIA E PS VENDIMET

Puna e dobët, Kryesia e PS propozoi shkarkimin e krerëve socialistë në nivel bashkie

"Shkëputën lidhjet me qytetarët", 11 kryetarët e PS që do shkarkohen

Rama ankohet për neglizhencën e drejtuesve vendorë

Partia Socialiste do shkarkojë të gjithë kryetarët e degëve të saj në rang bashkie që kanë punuar keq. Propozimi është bërë dje gjatë mbledhjes së përbashkët të Kryesisë së PS-së dhe grupit parlamentar, ku i pranishëm ishte edhe kryeministri Edi Rama. Propozimi është bërë i njohur për mediat pas mbledhjes nga zëdhënësja e kryesisë së kësaj force, Elisa Spiropali, e cila në fakt e bëri këtë fakt të kryer, duke deklaruar shkarkimin e 11 krerëve të degëve të Partisë Socialiste. "Në mbledhjen e sotme të kryesisë u shkarkuan 11 kryetarë socialistë. Janë vënë re vonesa të pajustificueshme në riorganizimin e partisë, në fushatën e anëtarësimeve dhe në degët lokale", tha Spiropali. Por, duket se kemi të bëjmë me një lapsus të Spiropalit, pasi menjëherë pas kësaj deklarate, nga selia rozë u qartësua se gjatë mbledhjes së kryesisë nuk ishte marrë vendimi i shkarkimit, por vetëm ishte diskutuar propozimi për shkarkim të 11 kryetarëve të PS-së në nivel bashkie. Madje, nga zyra e shtypit u bë e ditur se tashmë ky propozim do të diskutohet me drejtuesit politikë të qarqeve si dhe asambletë e rretheve për të vendosur më pas nëse do të vendoset për shkarkimin e tyre ose jo.



VENDIMARRJA

Burime nga Kryesia e PS-së bëjnë të ditur se arsyet e këtij propozimi drastik lidhen me punën e dobët të bërë prej tyre në drejtimin e partisë, sidomos sa i përket përbushjes së detyrimeve që lindën nga vendimarrja e mbledhjes së fundit të Asamblesë Kombëtare. Bëhet fjalë për proceset organizative në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme, si dhe fushatën e anëtarësimeve në parti.



Foto ilustruese

KRYETARËT E PS QË JANË PROPOZUAR PËR T'U SHKARKUAR

1. ARVIT OSJA - SHKODËR
2. GËZIM SALLA - CËRRIK
3. AFRIM MIKLI - DIBËR
4. AGRON IVANI - KURBIN
5. EDVIN TUCI - PËRMET
6. NERTIL BELLAJ - SELENICË
7. EROLD BEGOLLI - DEVOLL
8. EDMONDA HARIZAJ - MEMALIAJ
9. ABEDIN KATANA - TROPOJË
10. ELTON ARBANA - SHIJAK
11. ARJAN ÇEPELE - URA VAJGURORË

'STATUTI', NENI 31

KRYETARI I PARTISË SË BASHKISË

Mandati i kryetarit të partisë së bashkisë si rregull është 4 vjet. Mandati i tij ndërpritet para kohe kur:

- Jep dorëheqjen
- Shkarkohet nga kryesia e partisë për dobësi në punë e shkeljet të normave të statutit.
- Nuk fiton në mocion votëbesimi të zhvilluar për të.
- Humbet besimin e anëtarësisë dhe të organizatave socialiste të bashkisë dhe shkarkohet prej tyre.
- Humbet zgjedhjet vendorë, ose arrin rezultat më të dobët se zgjedhjet e mëparshme politike në bashkinë respektive.
- Në rastet e mësipërme, mandati ndërpritet automatikisht dhe kryetari qëndron në detyrë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.

ARSYET

Burime nga Kryesia e PS-së bëjnë të ditur se arsyet e këtij propozimi drastik lidhen me punën e dobët të bërë prej tyre në drejtimin e partisë, sidomos sa i përket përbushjes së detyrimeve, që lindën nga vendimarrja e mbledhjes së fundit të Asamblesë Kombëtare. Bëhet fjalë për proceset organizative në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme, si dhe fushatën e anëtarësimeve në parti. Mësohet se ka qenë vetë kryeministri Edi Rama, ai që është ankuar për neglizhencën e socialistëve, përfshi kryetarët e degëve, drejtuesit e pushtetit vendor dhe ka kërkuar nga drejtuesit politik të çdo qarku që të analizojnë veprimtarinë e tyre dhe në mënyrë të veçantë atë të drejtoreve lokale. "Vihet re një shkëputje nga disa terri-tore. Drejtuesve politikë u

është kërkuar që të rrisin prezencën në territor dhe në qarqet që mbulojnë, sidomos në bashkitë që drejtohen nga opozita, ku vihet re një degradim i madh i marrëdhënies së pushtetit lokal me qytetarët", shtoi Spiropali.

EMRAT

Në listën e krerëve të PS-

"Dosjet", socialistët kritika kandidatëve: Të interesuar vetëm për rrogën

Komisioni i Ligjeve ka marrë në shqyrtim kandidatët që kanë paraqitur interes për t'u bërë pjesë e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit 1944-1991, ku aktualisht ka mbetur një vend vakant, pas largimit të Daut Gumenit. Por, disa nga deputetët socialistë kanë shprehur rezervë për punën e Autoritetit dhe në mënyrë të veçantë për disa nga kandidatët e paraqitur. Sipas Spartak Brahos dhe Bashkim Finos, disa prej kandidatëve janë të interesuar më shumë për rrogën se sa për punën. "Çfarë ndryshon tek ju në qoftë se Kuvendi voton për anëtarë të këtij Autoriteti nga pozicioni që kenë, që jeni drejtor i një drejtorie shumë të rëndësishme, apo tjetri para jush. Nëse




është për çështje rroge, nuk ia vlen të vinë këtu dhe t'i votojmë fare", tha deputeti Bashkim Fino. Ndërsa deputeti tjetër, Spartak Braho adresoi kritikë në drejtim të kryetares së këtij autoriteti, Genta Sulës. Në listën prej 7 kandidatësh të propozuar nga shoqatat e ish-të

përndjekurve politikë bëjnë pjesë edhe emra të njohur dhe që janë marrë prej vitesh me çështjen e të përndjekurve politikë dhe dosjet. Bien në sy Besim Ndrejoni, kryetar i njëres prej shoqatave të të përndjekurve; Ermira Shtino, e cila më parë ka punuar drejtoreshë për dëshmipërblimin e të përndjekurve; Nevila Nika, ish-drejtoreshë e Arkivit Qendror Shtetëror, apo edhe Skënder Vrioni, ish-sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së. Në mars të këtij viti, Daut Gumeni dha dorëheqjen nga Autoriteti për Hajpen e Dosjeve duke e akuzuar këtë institucion se ka dështuar në punën e tij, pasi që nga fillimi e deri më sot nuk ka hapur asnjë dosje të rëndësishme.

Osja dhe për të vijuar me kryetarin e PS-së në Tropojë, Abedin Katana; kryetarin e PS-së Përmet, Edvin Tuci; atij të Devollit Erold Begolli, atij të Selenicës, Nertil Ballaj apo edhe ai i Cërrikut, Gëzim Salla. Të gjitha këto, bashki që në pushtetin vendor drejtohen nga përfaqësues të PD dhe LSI. Pjesë e

listës së kryetarëve që kanë punuar keq janë edhe kryetarët e PS-së në Dibër, Kurbin, Memaliaj, Shijak dhe Ura Vajgurore. Gjithësi, tashmë verdikti për fatin e këtyre drejtuesve socialistë është në dorë të drejtuesve politikë të qarqut, të cilët do duhet të bëjnë edhe një analizë më të thelluar

TAKIMI



Xhaçka: Shqipëria do të kryesojë disa nisma rajonale vitin që vjen

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka priti dje në një takim të veçantë homologen e saj italiane, Elisabetta Trenta. Gjatë takimit, ministria Xhaçka vlerësoi Italianë si një nga partnerët më të ngushtë dhe aleatë historike e rrugëtimin të Shqipërisë për integrim në strukturat euroatlantike. Ministria Xhaçka i konfirmoi homologes Trenta vullnetin e plotë të Shqipërisë për të vijuar me ritmin që kërkohej, përfaqësimin në operacionet, misionet dhe iniciativat në kuadër të NATO-s.



Valentina Madani

Komisioni i Ekonomisë miratoi dje vetëm me votat e mazhorancës ndryshimet në ligjin për "Lojërat e Fatit", i cili i hap rrugë mbylljes së aktiviteteve të kazinovave dhe basteve pas 31 dhjetorit. Nga 1 janari i vitit 2019 mbyllet të gjitha bastet sportive, bingot, bastet me gara dhe lojërat e fatit "online". Kreu i komisionit Erjon Braçe bëri të qartë se ky ligj mund të hyjë menjëherë në fuqi, pasi për këtë nuk ka pasur asnjë rezervë nga Presidenti Ilir Meta. Ai vuri në dukje se në këtë formë i japim fund veprimtarisë së tyre, si dhe përfundojmë varësisë e brezave të ri, si dhe veprimtarinë e paligjshme. Braçe do i kërkojë parlamentit që të përcaktojë barrën fiskale të re për subjektet që do të mbeten në treg. Pas miratimit të projektligjit në Komisionin e Ekonomisë, parlamenti pritet të vulosë të enjten nismën e qeverisë për mbylljen e basteve sportive, të lojërave të fatit dhe ndalimin e bixhozit edhe online. Komisioni i Ekonomisë miratoi pa opozitën projektligjin, i cili do të kalojë për votim në Kuvend. Në draft parashikohet që kjo industri të jetë monopol shtetëror. E ndërsa ndalohen reklamat, disa nga objektivat e ligjit që pritet të miratohet të enjten janë: mbrojtja nga lidhjet me krimin; parandalimi i kërcënimit për integritetin e konkurrencës sportive nëpërmjet verifikimit të veprimtarisë së fiksimit të rezultateve sportive, por edhe kundërveprimi për të siguruar të rinjtë dhe lojtarët. Projektligji parashikon mbylljen e të gjitha lojërave të basteve; baste, baste dhe kazino online, lojëra elektronike, kazino dhe bingot. Janë rreth 4200 pika basteve në të gjithë vendin që mbyllet, ndërkohe që në to janë të punësuar afro 7400 persona. Si pas ministrit të Financave, Arben Ahmetaj i pranishëm dje në komision,

Përgjegjësia e shtetit, çfarë parashikon projektligji për mbylljen e basteve sportive

Mbyllet lojërat e fatit, Braçe: Meta asnjë rezervë

Ahmetaj: Efektet financiare të pallogaritshme



Komisioni i Ekonomisë

EDI RAMA

Kryeministri Rama përshëndeti dje vendimin e mazhorancës për miratimin e projektligjit për mbylljen e lojërave të fatit. "FLM deputetëve të Komisionit të Ekonomisë e Financave, për mbështetjen me votën sot të projekt-ligjit për ndalimin e bixhozit! Tani në Komisionin e Ligjeve dhe të enjten të gjithë në Kuvend për nënat e gratë, në radhë të parë, dhe për një mesazh të qartë kërimit të organizuar", - shprehet z.Rama.

TABAKU

Opozita nuk ishte dje në Komisionin e Ekonomisë dhe do të mungojë edhe kur ligji për mbylljen e lojërave të fatit të shkojë për miratim në parlament. Jorida Tabaku shpjegoi për Tçh pasojat e vendimit të kryeministrit. "Do rrisë i informalitetin. E pamë në 5 vite vendosja e TVSH, për biznesin e vogël mbylli biznesin, por bizneset prapë po operojnë pa kupon. Kjo do jetë rezultati i parë i vendimit për lojërat e fatit. E ka të pamundur ta zbatojë kështu siç e ka sjellë sistemin në këtë ditë. Vendimi i qeverisë do të rrisë", tha Tabaku. Nënkyetaria demokratike e Komisionit të Ekonomisë pranon se zgjidhja për bastet para vitit 2013 nuk ishte me optimalja, por bëri të mundur kufizimin e lojërave të fatit. Opozita siguron se kur të vijë në pushtet do e rregullojë sistemin.



Partia

Meta në Vjenë: Austria mbështet integrimin e Shqipërisë në BE

Presidenti Ilir Meta po zhvillon një vizitë zyrtare në Vjenë, ku u prit nga presidenti austriak Aleksander Van der Bellen. Gjatë mbajtjes së një konference të përbashkët kreu i shtetit, vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera mes dy vendeve ndërsa falënderoi Austrinë për mbështetjen në rrugën europiane të Shqipërisë. "Shqipëria dhe Austria, janë mike tradicionale e aleate të ngushta", tha Meta. Presidenti i shprehu mirënjohje Austrisë për gjithçka ka bërë që nga krijimi i shtetit modern shqiptar. Teksa përgëzoi Presidentin Van der Bellen për kryesimin e suksesshëm austriak të Presidencës së BE-së, Meta tha Shqipëria po punon fort për çeljen e negociatave dhe anëtarësimin në BE. "Çdo 28 Nëntor kujtojmë me mirënjohje për mbështetjen që na ka dhënë Austria. Mirënjohës për ndihmën bujare dhe aleancën solide të Austrisë. Përgëzoi Presidentin Van der Bellen për kryesimin e suksesshëm austriak të Presidencës së BE", - tha Meta.

efektet financiare janë të pallogaritshme në krahasim me plagën sociale që ka shkaktuar kjo industri. "Pas datës 31 dhjetor asnjë subjekt nuk mund të vendosë kazino apo lojëra. Lotaria Kombëtare ka një pretendim se i lejohej të vendoste lart e poshtë lojëra, por nuk ka të drejtë, zero! Industria do të krijojë një diferencë në të ardhurat, por për ne nuk ka pikë rëndësie. Ne po e sfiidojmë administratën tati-more, t'i mbledhin në terren. Kjo është një sfidë për të mbajtur një trajktore të ekonomisë. Kjo qeveri sot konsolidon qëndrimin sa i përket lojërave të fatit", tha z.Ahmetaj. Mbyllja e basteve dhe lojërave të fatit prek vetëm sektorin privat, pasi komisioni miratoi një nen në ligj, i cili i jep mundësi shtetit organizimin e tyre. Deputeti socialist Ervin Bushati tha: "Organizimi dhe ndër-

mjetësimi i lojërave të fatit dhe lotarive sportive është përgjegjësi e shtetit. Ky ligj ka objektiv parandalimin e varësisë ndaj lojërave të fatit dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për luftë efektive ndaj kësaj

varësie; kontrollin e kësaj varësie në kanale të kufizuara, të mbrojtura dhe të supervizuara për të mos lejuar zhvillimin dhe përhapjen e tyre në mënyrë të paligjshme në tregun e zi".

U pagua nga Greqia? Idrizi: A jeni në terezi të kokës, o shqiptarë?

Kreu i PDIU-së Shpëtim Idrizi, reagoi dje pas publikimit të një lajmi në portale, se ai ka marrë para nga fondi sekret i Ministrisë së Jashtme greke. Idrizi mohon kategorikisht akuzat. Sipas Idrizit lajmi është prodhuar nga "mashtruesit dhe agjentit të Asfalisë Greke, Festim Lato dhe këtë e dinë mirë dhe SHISH-i dhe autoritetet e tjera shqiptare, i cili për bëmat e tij të mashtrimit nuk hyn dot prej vitesh në Shqipëri". Idrizi shprehet se disa portale në vendin tonë nuk kanë marrë as mundimin më të vogël për të bërë një kontroll të thjeshtë në internet për të mësuar se kush qëndron pas këtij lajmi. "Për të gjithë ata që e çuan në cep të mendjes kam vetëm një pyetje: A jeni në terezi të kokës, o shqiptarë, që u sulët si të marrë se gjetët "tradhëtarin"? Çamëria



Kreu i PDIU-së Shpëtim Idrizi

NIKOS KOTZIAS

Ish-ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias i cilësoi dje si "karagjozllëqe që i bëjnë dëm vendit", zërat për keqadministrim nga ana e tij të fondeve sekrete të ministrisë. është sa e imja aq edhe e çdo shqiptari. Çamëria pati fatin e keq që u sakrifikua se ishte në skajin më jugor të Shqipërisë, që të kemi këtë Shqipëri politike të mbetur e gjymtuar sot... Ju garantoj vetëm për një gjë, që nuk do të rresht së punuari për Çamërinë, tani akoma dhe më me shumë forcë e inat", - shprehet z.Idrizi.

NJOFTIM

Shoqëria "GPP Korça" sh.p.k, propozon ndërtimin dhe operimin e një termocentrali me gaz me cikël të kombinuar kogjenerimi CCCPP KORÇA 500 MW/ 80 MW/ 6 MW në zonën pranë qytetit të Korçës, saktësisht përballë Impiantit të Trajtitimit të Ujërave të Qytetit të Korçës. GPP Korça ka kontraktuar kompaninë ABKONS sh.p.k. për realizimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, si shoqëri e lincensuar për veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis.

Për këtë qëllim, Ju njoftojmë se në Korçë do të mbahet një Dëgjues Publike për të bërë publike rezultatet e vlerësimit mjedisor dhe për të diskutuar dhe mbledhur komentet dhe sugjerimet nga pjesëmarrësit.

Dëgjesa Publike do të mbahet në datën **26 Tetor 2018** në orën **12:00** ne sallën e takimeve tek "Grand Hotel Korça"

SARANDË - Një 25-vjeçar nga Korça ka përfunduar në pranga, pasi ka tentuar të fusë në Shqipëri një shumë prej 145 mijë paund të padeklaruara. Denis Duro u kap teksa hynte nga Greqia nëpërmjet pikës kufitare të Qafë Botës. I riu akuzohet për veprat penale: "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe sendeve me vlerë" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës pe-



Tentoi të fusë në Shqipëri 145 mijë paund të fshehura në lavatriçe, prangoset 25-vjeçari

nale". Burime zyrtare nga policia e Sarandës dje bënë me dije se i riu ishte duke udhëtuar me automjetin tip Mercedes-Benz Sprinter, me targa BV 67 KWN, kur ka hyrë nga vendi fqinj nëpërmjet pikës së kalimit kufitar në jug të vendit.

"Strukturat operativo-hetimore të Doganës në Sarandë në bashkëpunim me Policinë, kanë ndaluar në aksin rrugor Qafë Botë-Sarandë automjetin që drejtohej nga ky shtetas dhe e kanë shoqëruar në PKK Kakavijë për një kontroll të imtë-

sishëm me skaner, pasi strukturat operativo-hetimore të Doganës dhe Policia dispononin informacion se ky shtetas po transportonte një shumë të madhe parash, të cilat nuk i kishte deklaruar në kufi. Pas kontrollit të imtësishëm dhe me skaner të

bërë në Kakavijë, në disa lavatriçe, Policia dhe Strukturat operativo - hetimore të Doganës, gjetën dhe sekuestruan 145 220 Paund anglezë dhe skocezë. Në përfundim të veprimeve u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit Denis Duro dhe materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë për veprime të mëtejshme", - thuhet në njoftimin e policisë.

Policia: Të arrestuarit komunikojnë me kode, ja rolet e tyre në grup

Trafiku i drogës Shqipëri-Mali i Zi, goditet grupi kriminal prej 6 personash

Operacioni "TAMARA", sekuestrohen 80 kg kanabis

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Një tjetër grup kriminal që merrej me trafikun e drogës është goditur nga policia e Shkodrës dhe ajo e Malësisë së Madhe. Gjatë operacionit të bluve është sekuestruar një sasi prej 80 kg kanabis, ndërsa kanë përfunduar në pranga 6 persona. Bëhet fjalë për shtetasit: Kristjan Butaj, Gjetjo Pepaj, Pëllumb Murçaj, Lazer Murçaj, Lavdrim Nikaj dhe Ndue Milaj, të cilët u kapën në Tamarë të Malësisë së Madhe në afërsi të një pike kufitare. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë Vendore të Shkodrës dje bënë me dije se personat e prangosur dyshohen të jenë pjesë e një grupi të strukturuar kriminal. Po sipas bluve, sasia e drogës po tentohej që të transportohej përmes pikës kufitare drejt Malit të Zi me destinacion vende të tjera të Europës. Sipas burimeve të mësipërme, 44-vjeçari Gjetjo Pepaj cilësohet si më kryesor i këtij grupi të trafikut të drogës.

OPERACIONI ANTIDROGË

Pas një pune të mirëorganizuar dhe disa mujore, policia e Shkodrës në bashkëpunim me prokurorinë e rrethit realizua finalizuan me sukses operacionin e koduar "TAMARA", duke vënë në pranga shtetasit e mësipërm. Arrestimi i tyre u bë, për arsye se nga tërësia e veprimeve policore dhe hetimore të kryera prej një periudhe kohore disa mujore në funksion dhe të procedimit penal, u arrit që të bëhet goditja finale e këtij grupi kriminal dhe dokumentimi i aktivitetit të tyre. Ky grup e kishte shtrirë aktivitetin kriminal në qytetet Shkodër, Malësi e Madhe, Mali i Zi, ku në fshatin Tamarë në vendin e quajtur "Përoi i Pojata" po kryenin transportimin e lëndës



Sekuestrimi i hashashit nga policia

Trafiku



PRECEDENTI

Ky nuk është rasti i parë, sepse edhe më përpara grupe apo persona të ndryshëm janë arrestuar duke transportuar sasi të ndryshme droge nga Shkodra drejt Malit të Zi ndërsa pak kohë më parë në liqenin e Shkodrës tek Vija e Vrakës u gjet drogë e braktisur në brigjet e liqenit që dyshohet se përdorej për transport në shtetin fqinj të Malit të Zi.

narkotike. Në momentin e ndërhyrjes së policisë janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe 80 kg kanabis sativa. Në këtë grup kriminal, të gjithë personat e arrestuar kanë pasur rolin e tyre dhe në një kohë të shkurtër kanë arritur të sigurojnë lëndën narkotike me qëllim shitjen dhe trafikimin e saj. Mësohet se ata bashkëpunonin me njëri-tjetrin dhe komuni-

konin herë pas here me kode për transportimin e drogës nga Shqipëria drejt Malit të Zi. Gjatë zhvillimit të operacionit gjashtë personave në fjalë u janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale: 80 kg, lëndë narkotike; 2 automjete të markës 'Benz Mercedes' me targë AA669FO dhe mjeti 'BMW' me targë AA429JP; një sasi lekësh dhe 6 telefona celularë të markave të ndryshme.

ROLET NË GRUP

Sipas policisë, në këtë grup kriminal, të gjithë personat e arrestuar kanë pasur rolin e tyre dhe në një kohë të shkurtër kanë arritur të sigurojnë lëndën narkotike me qëllim shitjen dhe trafikimin e saj. Mësohet se ata bashkëpunonin me njëri-tjetrin dhe komunikojnë herë pas here me kode për transportimin e drogës nga Shqipëria drejt Malit të Zi.

PERSONAT E ARRESTUAR GJATË OPERACIONIT TË KODUAR "TAMARA"

- 1. Gjetjo Pepaj**, 44 vjeç, banues në fshatin Tamarë, Malësi e Madhe, i arrestuar në flagrancë për veprat penale "Trafikim i lëndëve narkotike" dhe "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike" në bashkëpunim
- 2. Pëllumb Murçaj**, 42 vjeç, banues në Vukël, Kelmend, Malësi e Madhe, i arrestuar në flagrancë për veprat penale "Trafikim i lëndëve narkotike" dhe "Prodhim dhe shitje lëndëve narkotike" në bashkëpunim
- 3. Lazer Murçaj**, 31 vjeç, banues në Vukël, Kelmend, Malësi e Madhe, i arrestuar në flagrancë për veprat penale "Trafikimi i lëndëve narkotike" dhe "Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike" në bashkëpunim
- 4. Ndue Nilaj**, 52 vjeç, banues në Vukël, Kelmend, Malësi e Madhe, i arrestuar në flagrancë për veprat penale "Trafikim i lëndëve narkotike" dhe "Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike" në bashkëpunim
- 5. Kristian Bujaj**, 18 vjeç, banues në fshatin Dobri, Selcë, Malësi e Madhe, i arrestuar në flagrancë për veprat "Trafikim i lëndëve narkotike" dhe "Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike" në bashkëpunim
- 6. Lavdrim Nikaj**, 34 vjeç, banues në lagjen 'Guerrile' Shkodër, i arrestuar në flagrancë për veprat penale "Trafikim i lëndëve narkotike" dhe "Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike" në bashkëpunim.



U kap për llogari të palës italiane, 37-vjeçarit i dëgjin servisin

ELBASAN - Servisi i automjeteve në pronësi të një 37-vjeçari është dëgjuar në orët e para të mëngjesit të djeshëm në Elbasan. Pronari rezultoi të jetë Elton (Kastriot) Kila, banues në lagjen "Qemal Stafa", i cili është arrestuar vetëm 6 ditë më parë gjatë aksioneve të befasishme të policisë së Elbasanit në lokale dhe akse rrugore. Sipas policisë Kila, u ndalua u bë me qëllim ekstraditim për në Itali, pasi Prokuroria e Peshcarës/Itali, ka lëshuar urdhrin e ndalimit ndërkomëtar datë 11.09.2018, për kryerjen e veprave penale "Organizata kriminale", "Trafikim i narkotikëve", "Mashttrim" dhe "Kallëzim i rremë". Nisur nga e kaluara e pronarit, policia e Elbasanit po heton pas zjarrvënies për konflikte të mëparshme të tij ose prishje pazeresh. Si pasojë e zjarrit, në servisin e 37-vjeçarit në lagjen "Skënderbej" në Elbasan shkruanban disa makina luksoze.

Prokuroria: Dëshmitari kyç i ngjarjes ka refuzuar të dorëzojë një pistoletë



TIRANË

Vrasja në ish-Bllok, Gjykata e Tiranës liron pronarin e lokalit, Redi Popesku

40-vjeçari lihet në "Arrest shtëpie", reagon avokati: Vendimi i padrejtë, klienti im nuk ka fshehur armë

Gjykata e Tiranës ka liruar pronarin e lokalit Redi Popesku, ku më 4 tetor ndodhi vrasja në ish-Bllok. Seanca gjyqësore u zhvillua me dyer të mbyllura për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor. Mësohet se togat e zeza të kryeqytetit vendosën masën e sigurisë "arrest shtëpie" ndaj tij. Redi Popesku u vu në pranga tri ditë më parë në lokalin e tij me kërkesë të prokurorisë, pasi akuzohet se ka gjenyer në dëshminë e tij, por edhe se ka fshehur një tjetër pistoletë, që është përdorur atë natë duke e larguar atë nga vendi i ngjarjes. Bëhet fjalë për një armë me leje, për të cilën pronari i lokalit në ish-Bllok ka bërë një denoncim, duke u shprehur se i ka humbur dhe për këtë arsye nuk e ka dorëzuar. Ndërkaq, pas seancës gjyqësore, avokati mbrojtës i Redi Popeskut tha se vendimi për i gjykatës për klientin e tij nuk është i drejtë, pasi nuk ka fshehur asnjë armë siç pretendohet. "Vendimi i Gjykatës së Tiranës për Redi Popeskun nuk është i drejtë dhe nuk mund të caktohet masë sigurie. Prokurorët mund ta kishin zgjidhur me urdhër ndalimi dhe jo me arrest në flagrancë. Ndaj tij nuk mund të vendoset një masë e tillë, pasi ai nuk mund të pengojë të vërtetën. Janë marrë gëzhojat nga vendngjarja dhe janë çuar për ekspertizë. Pra, asnjë veprim që ai mund të kryejë nuk e pengon të vërtetën. Ai nuk ka fshehur asnjë armë. Ai ka leje për një pistoletë dhe disa armë të tjera mes tyre edhe një çifte. Në nuk thamë që ai

VRASJA NË ISH-BLLOK

Më 4 tetor të këtij viti, në një lokal në zonën e ish-Bllokut, pas një shkëmbimi zjarri mbeti i vrarë Fabian Gaxha, ndërsa u plagosën Ervis Martinaj dhe Elion (Esmerald) Hato. Sipas policisë, të përfshirë në këtë ngjarje kanë qenë edhe pronari i lokalit Redi Popesku, komando Mervjot Bilo, Ervin Mata dhe Fabjot Alushi. Gjithashtu, në këtë ngjarje u përfshi dhe këngëtarja e njohur Elvana Gjata, e cila u etiketua si "molla e sherrit".



Redi Popesku

nuk e dorëzoi armën. Problemi është se Popesku është thirrur për të dorëzuar armën dhe meqenëse prokurorët nuk e kanë gjetur aty në atë moment kanë bërë arrestimin i Popeskut. Deri më sot arma nuk është dorëzuar. Nëse kërkohet, arma do të merret dhe me të do të eksperimentohet për të parë nëse në vendngjarje janë përdorur të njëjtat gëzhoja", tha avoka-

ti Adrian Leka.

ARRESTIMI

Redi Popesku u arrestua tri ditë më parë me dyshimet se po pengon autoritetet për të hedhur dritë mbi ngjarjen e ndodhur në lokalin e tij, ku pas një shkëmbimi zjarri humbi jetën i riu Fabian Gaxha, ndërsa mbetën të plagosur Ervis Martinaj dhe Elion (Esmerald) Hato. Më herët burime nga prokuror-

ia bënë me dije për "Gazeta Shqiptare" se 40-vjeçari Popesku, i cili është edhe një nga dëshmitarët kyç i ngjarjes së rëndë, ka refuzuar në mënyrë të përsëritur kërkesën për të dorëzuar një pistoletë, të cilën e disponon me leje. Institucioni i akuzës këmbëngul për sekuestrimin e armës, për të konfirmuar përmes ekspertizës balistike, nëse me të

është realizuar qitje, çka do ta ndryshonte tërësisht rrjedhën e ngjarjes, ku mbeti i vrarë Gaxha dhe u plagosën Martinaj dhe Hato. "Biznesmeni Popesku thanë burimet ka pranuar të dorëzojë vetëm një armë gjahu, të cilën gjithashtu e disponon me leje, por kjo nuk i shërbon hetimit, pasi në ngjarje dyshohet të jenë përdorur tri pistoletat".

POLICIA

Arrestohet një tjetër shtetas në lidhje me ngjarjen e ndodhur në një lokal në mbrëmjen e 04.10.2018, ku mbeti i vrarë me armë zjarri shtetasi F.G., dhe u plagosën shtetasit E.H., dhe E.M. Specialistët për Hetimin e Krimeve të Rënda ndaj Jetës dhe Pronës arrestuan për veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës", shtetasin Redi Popesku, 40 vjeçar, banues në Tiranë. Materialet u referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të shtetasit të lartpërmendur për veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.



Doli me leje nga burgju dhe u arratis, arrestohet 36-vjeçari

VLORË - Policia e Vlorës ka prangosur një 36-vjeçar, i cili ishte shpallur në kërkim, pasi ishte "arratisur" nga vendi ku ishte duke vuajtur dënimin. Mësohet se Ervis Gjini ishte i dënuar për trafikim të lëndëve narkotike, por pas marrjes së lejes nga burgju i Fierit, ai nuk është kthyer më. Ndaj tij rëndonte edhe akuzat e "Vjedhjes" dhe për këtë Gjykata e Shkallës së Parë në Vlorë e kishte dënuar më parë me 2.6 vite burg. Arrestimi i tij u bë në qytetin bregdetar. "U largua nga vendi i vuajtjes së dënimit, kapet nga policia e Vlorës i kërkuari Ervis Gjini, banues në Vlorë. Kapja dhe ndalimi i tij u bë në lagjen '1 Maji', për arsye se ky shtetas vitin e kaluar ka qenë duke vuajtur dënimin në burgun e Fierit për veprën penale 'Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike', por kur ka dalë me leje për në vendin e banimit Vlorë, ka tejkaluar afatet duke mos u kthyer më. Gjithashtu, ky shtetas ka qenë në kërkim edhe për një tjetër veprë penale në fushën e vjedhjes, pasi akuzohet për 'Vjedhje' të kryer në bashkëpunim me shumë se një herë, për të cilën Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë e ka dënuar me 2 vite e 6 muaj burg. Materialet u referuan Prokurorisë në ngarkim të tij për veprat penale 'Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit' dhe 'Vjedhja' të kryer në bashkëpunim me shumë se një here", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

Prokuroria kërkon dënimin me 64 vite burg në total

Shtyhet sërish seanca gjyqësore për bandën "Shullazi", avokatët: Duam më shumë kohë

TIRANË - Shtyhet sërish seanca gjyqësore për dosjen "Shullazi". Ndonëse seanca ishte parashikuar të zhvillohej dje në orën 10:00, avokatët mbrojtës të të pandehurve kanë kërkuar më shumë kohë për përgatitjen e mbrojtjes. Pas kërkesës, Gjykata e Krimeve të Rënda ka vendosur të shtyjë seancën për në datën 30 tetor, ndërsa në sallë nuk ishte pjesëmarrës asnjë nga të pandehurit. Rreth dy javë më parë, Prokuroria e Krimeve të Rënda dha pretendencën për Emiljano Shullazin dhe 4 anëtarë të tjerë të grupit të tij, që akuzohen për gjobvënie. 64 vite burg në total ka kërkuar Prokuroria për Shullazin dhe bashkëpunëtorët e tij. Konkretisht, Prokuroria e Krimeve të Rënda kërkoi 17 vjet burgim për Emiljano Shullazin, 15 vjet burgim për Gilmando Danin, nga 11 vjet burgim për Endri Zelën dhe Endrit Qyqen dhe 10 vjet burgim për Blerim Shullazin. Në materialet prej 66 faqesh, prokurorët kishin renditur argumentet dhe provat



Emiljano Shullazi në sallën e gjyqit

mbi bazën e të cilave kërkuan edhe fajësinë e të akuzuarve. Sipas tyre, Shullazi dhe anëtarët e grupit të drejtuar prej tij, përmes shantazhit, kërcënimit fizik e psikologjik, si dhe kanosjes me armë, i kanë zhvatur Ylvi Begjas shumë në prej 500 mijë eurosh. Paratë

- thanë prokurorët - Ylvi Begja ua ka dorëzuar 'cash' dhe përmes çeqeve bankare. Mendimi kriminal për t'i marrë paratë Begjas theksohet në dosje i ka lindur Shullazit në momentin kur biznesmeni, që mban statusin e të penduarit të drejtësisë i kërkoi ndihmë për të regjis-

PRETANJA E PROKURORISË PËR BANDËN E SHULLAZIT

- EMILJANO SHULLAZI - 17 VITE BURG
- GILMANDO DANI - 15 VITE BURG
- BLERIM SHULLAZI - 10 VITE BURG
- ENDRIT QYQJA - 11 VITE BURG
- ENDRIT ZELA - 11 VITE BURG

truar në hipotekë ish-hotel "Vollgën". Për këtë shërbim, ai i kishte premtuar Shullazit 20% të aksioneve, por kur më vonë e ka shitur pronën tek një biznesmen, i pandehuri i ka kërkuar që t'i jepte paratë dhe më shumë aksione nga pronat. Banda "Shullazi" akuzohet se ka kërcënuar për dhënie pasurie edhe biznesmenit Jani Zaka e Adriatik Kërçuku, por kur ka hasur rezistencën e tyre, ua ka shkatërruar pronat me ek-

sploziv. Prokuroria theksoi se biznesmeni Zaka, i ndërë i kërcënuar për jetën është larguar nga Shqipëria bashkë me familjen. Për kërcënimin e dy profesoreve Dhori Kule dhe Mynyr Koni, për ta detyruar këtë të fundit që të tërhiqej nga gara për rektor, prokuroria u referua dëshmi të dhëna nga zyrtarë të lartë të shtetit dhe policisë shqiptare, përmes të cilave pretendon se provohet fajësia e Shullazit dhe grupit të tij.

ERNESTO CHE GUEVARA MITI DHE E VERTETA

Historia e panjohur e rebelit të famshëm dhe aventurier që braktisi Kubën, për të luftuar si guerillas

Ernesto Che Guevara, mes mitit dhe të vërtetave

Enigma e qëndrimit të Fidel Kastros, i cili nuk pati predispozitën për ta ndihmuar Che në aventurën e tij

Spartak Topollaj



Vëshirë të gjendet një tjetër personalitet kaq kompleks dhe kaq kontradiktor i shekullit të XX, si ai i Ernesto Che Guevarës, të cilin revista "The Times", e fut ndër 100 figurat më me ndikim të shekullit të kaluar, e që këtë vit po të ishte gjallë, do të mbushte 90 vjeç. Në të vërtetë, ai jetoi vetëm 39 vite dhe këto ditë, për kohëzgjatje, u bënë plot 51 vite nga vrasja e tij.

Ernesto Che Guevara u lind në Rosario, Santa Fe-Argjentinë, më 14 qershor 1928 dhe vdiq i ekzekutuar në La Higuera, Vallegrande - Bolivi, më 9 tetor 1967. Familja e tij gëzonte pasuri të konsiderueshme. Babai, Ernesto Guevara Lynch, me origjinë spanjollo-irlandez, ishte një inxhinier i njohur, saktësisht arkitekt, por që u kthye në pronar plantacionesh, ndërsa e ëma, Celia de la Serna y Llosa ishte një intelektuale poliglote, militante politike e lëvizjeve feministe. Che kishte dy motra dhe dy vëllezër, si dhe u martua dy herë zyrtarisht. Së pari me Hilda Gadea Akosta (1955-1959), revolucionare e majtë peruane, me lidhje e njohje të forta politike, diplomuar për ekonomi dhe së dyti me Aleida March (1959-1967), luftëtare kastriste kubane. Ai pati pesë fëmijë, një vajzë, e quajtur edhe ajo Hilda, me gruan e parë, saktësisht Hilda Beatriz "Hildita" Guevara Gadea (L.1956-V.1995) dhe katër të tjerë me Aleidën, dy djem dhe dy vajza, të cilët jetojnë edhe aktualisht: Aleida lindur më 1960, Camillo lindur më 1962, Celia lindur më 1963 dhe Ernesto lindur më 1965.

Che Guevara, ndoshta me dëshirën e babait, i nisi studimet e larta më 1948 në një tjetër fakultet, por shpejt ndërroi, mendje edhe iu përkushtua mjekësisë, në Universitetin e Buenos Airesit, ku pas një ndërprerjeje, diplomohet në korrik të 1953, duke pasur idhull Njutonin në fizikë dhe Pastërin në biologji. Me një shpirt aventurier e rebel, pa ndonjë shkak të qenësishëm, në këtë periudhë të jetës, Che na kujton në një farë mënyre Xhejms Dimin, në film-in hollivudian me të njëjtin titull, pra "Rebel pa shkak", që falë "RAI"-t, në fillim të viteve '70-të, e kemi parë si pjesë e një cikli me katër filma, quajtur "Rebelët e së djeshmes". Kështu,



më 1951, ai nisi të parën aventurë të madhe, teksa guxoi, të ndërmarrë një udhëtim të gjatë 4.500 km nëpër vendet e Amerikës Latine, me një biçikletë të modifikuar si motor së bashku me mikun e tij Alberto Granada (në një tjetër version, më të besueshëm, thuhet se udhëtuan me një "Norton" 500 Ç). Inkursioni i dytë me mikun Calica Ferrer u bë një vit më vonë më 1952, kësaj here me një motor italian, "Garelli" dhe ishte 8000 km i gjatë. Vendi i parë ku qëndroi më shumë ishte Guatemala, pasi iu dukën interesante dhe i pëlqyen reformat e presidentit të majtë, Jakobo Arbenz Guzman. Këtu lidhi kon-

taktet e para me revolucionarë kubanë të lëvizjes së 26 korrikut 1953, që kishin sulmuar pa sukses kazeremat Monkada në Santiago de Cuba. Po në këtë kohë, njihet dhe miqësorja me Helena Leiva de Holst (1897-1978), revolucionare e brumosur me ide marksiste në Bashkimin Sovjetik stalinian dhe Kinën e Maos, por kurë në nuk u mësuua se deri ku shkoi miqësia e tyre!

Pas disa kohësh, ai u njoh e u miqësua me një tjetër femër, që më pas do të bëhej bashkëshortja e parë e tij, Hilda Akosta Gadea, e cila kish mbërritur deri sekretare për Ekonominë e Partisë Komuniste. Më 1952, me


mbështetjen e diktatorit nikaraguan Somoza, atij dominikan Trujillo dhe atij venezuelan Jimenez, Presidenti Truman autorizoi Operacionin "PB-FORTUNE", që u pasua në gusht të 1953 nga Operacioni "PBSUCCESS", i autorizuar nga Presidenti pas tij, Aizenhauer. Ndërkohë, më 18 maj të 1954, në Guatemala kish mbërritur me anije një kamion i rëndë "Skoda", ngarkuar plot me armë çeke. SHBA nuk mund të rrinte indiferente, aq më tepër, që këtu ishin në lojë interesat e prekura nga reformat të gjigantit "Junajtëd Fruit" me aksionerë kryesorë vëllezërit Dalles, njëri sekretar shteti dhe tjetri drejtor i CIA-s! Në këtë mënyrë, amerikanët nxitën dhe frymëzuan rebelimin anti-Guzman, që filloi më 18 qershor duke organizuar një detashment special prej 480 trupash të mirësërvitura, të udhëhequra nga Karlos Kamillo Armas, gjë që e detyroi Guzmanin të japë dorëheqjen, duke kërkuar strehim politik në Ambasadën Meksikane, për t'ia lënë pushtetin Armasit, deri ditën që ky i fundit u vra nga një pjesëtar i Gardës së tij Personale (Romeo Vasquez) më 26 korrik 1957. Che kërkoi të luftojë, por zgjehjethej prej revolucionarëve vendas, të rënë në dëshpërim e të tërhequr pas humbjes, ndaj dhe vendos të kthehet në Argjentinë, për të vazhduar studimet e lëna në mes. Hilda ishte arrestuar dhe vetë Che, shpëton duke u strehuar në Konsullatën Argjentinase, ku qëndron deri sa siguron një leje për t'u larguar dhe ndërron papritmas destinacion, duke mbërritur në Nju Meksiko më 21 shtator 1954! Për një farë kohe punësohet në një spital dhe njëkohësisht bën edhe fotoreporterin për "Latina News Agency". Rilidhet me revolucionarët kubanë, njohur që në Guatemalë, si Lopez, që e prezantoi me Raul Kastron (qershor 1955), i cili pas pak kohe e njohu edhe me vëllain e madh Fidel Kastro Ruz, që po bënte emër si avokat me bindje të majta. Biografi i të dyve, Simon Reid Henry pohon se ato që i lidhën ngushtë Che me Fidelin ishin idetë revolucionare, madje ishte ky i fundit, që i kërkoi Che, t'iu bashkohej atyre në luftën guerile kundër regjimit të diktatorit proamerikan Fulgencio Batista. Ai pranoi menjëherë dhe u vëtofrua të bëjë mjekun e luftës, por në të vërtetë, më mirë se mjekun, si tregoi koha më vonë, ai bëri guerillasin e pamëshirshëm nën komandën e gjeneral Alberto Bajos, luftëtar i vjetër republikan spanjoll. Kastro në rininë e tij qe pjesë e Partisë Popullore Kubane të Eduardo Shibas, i vetëvrarë publikisht në



mënyrë të pakuptimë para mikrofonit të radios në shenjë proteste!

I porsa martuar me Hildën në Nju Meksiko (shtator 1955), Che i bashkohet grupit prej 82 luftëtarësh, që më 25 nëntor, të hipur në anijen Granma u nisën nga Meksika dhe zbarkuan në Kubë. Forcat qeveritare i pikasën dhe i shpartalluan, pasi 60 prej guerillasve u vranë apo u ekzekutuan pasi u kapën. Ata 22 që shpëtuan, të ndarë në dy grupe morën pyjet në Vargmalet Sierra Maestra, ku gjatën mbështetjen në fshatrat e zonës nga njerëzit e Frank Pais. Për fatin e Kastros dhe njerëzve të tij s'dihej gjë deri në fillimin e 1957, kohë kur edhe dha një intervistë të gjatë për Herbert Matthews i gazetës "The New York Times". Fitoret e para, edhe pse të vogla ishin ato të janarit 1957, ndërsa më mars ata sulmuan Presidencën dhe Radion Qendrore, ku mbeti i vrarë drejtuesi i tyre Jose Antonio Echeverria. Në korrik u vra në Santiago de Cuba dhe drejtuesi i njësive të Sierra Maestras, Frank Pais. Che ndërkohë u rrit shpejt në përgjegjësi dhe vetë Fideli e vuri në krye të Kolonës së Katërt, apo si njihje ndryshe Armata e Dytë. Edhe pse do i kthehemi më gjerë kësaj teme, këtu është rasti të paraqesim një tjetër Che, të pamëshirshëm, të egër dhe brutal, ndaj atyre që për dyshimin më të vogël si tradhtarë, spionë, apo thjeshtë dezertorë, ai vetë, apo me urdhër të tij u ekzekutuan! Shembulli më sinjifikativ ishte ekzekutimi i Eutimio Guerra-s, personalisht nga Che! Duke imituar CIA-n, e cila kish ngritur një radiostacion antiqeveritar në pyjet malore të Guatemalës, që luajti rol të rëndësishëm në rrezimin e Presidentit Guzman, Che ngriti në Sierra Maestra radion "Rebelde".

Në mars të 1958, kur forcat qeveritare filluan torturimin dhe ekzekutimin e të burgosurve, apo të kapurve rob, SHBA ndërprejnë furnizimin me armë të regjimit të Batistës. Tani forcat kastriste marrin zemër dhe zhvillojnë disa beteja të mëdha si ajo e Las Mercedes në korrik, ku u shpartalluan 1500 ushtarë të gjeneralit Kantilo dhe më →



Che Guevara me delegacionin shqiptar

← kryesorja ajo e Santa Klarës, që i hapi rrugën sulmit final mbi Havana, pas një marshimi çfilitës shtatë javor. Këtu shkëlqeu taktika e Che "sulmo dhe ik", vlerësuar me vonë edhe nga ekspert i njohur ushtarak, majori amerikan, Lerrri Bokman. Diktatori Batista arratiset për në Republikën Dominikane duke u gdhirë 1 janari i vitit 1959, madje thuhet bashkë me 300 milionë dollarë të grabitura, çka i mundësoi njëvite nga Che, të hyjnë në kryeqytet të nesërmen, pra më datën 2 Janar 1959, ndërsa Fidelit pritet me madhësi nga kubanezët një javë më pas, saktësisht më 8 janar 1959. Në luftën dyvjeçare dhanë jetën rreth 2000 luftëtarë. Në mes të janarit, Che pëson një atak të rëndë, si astmatik kronik që ishte dhe qëndron në një vilë pushimi në Tarara, ku bën dhe një muaj të dytë mjalti, por jo me Hildën, e cila tani që revolucionin fitoi, që kthyer në Kubë për t'u ribashkuar me Che-në. Ai kish kohë që bashkëjetonte me Aleida March (lindur më 1936), e cila guerdit që i përkiste lëvizjes së 26 korrikut dhe pa i thënë asgjë Hildës, përgatit dhe realizon divorcin

me të, më 22 maj, ndërsa vetëm pak ditë më vonë, më 2 qershor formalizon martesën e re me Aleidën. E zhgënjyer thellësisht, Hilda ra në dëshpërim të thellë, me një shëndet që sa vinte dhe përkeqësohej, deri sa edhe ndërroi jetë, kur sapo kish mbushur 46 vjeçe (1925-1974). Pasi e kaloi krizën astmatike, bëri muajt e njaltit dhe pushoi disa javë, Che, duke befasuar të gjithë, mësohet t'i ketë kërkuar Fidelit ta emëronte në krye të Burgut Fortesë "Kabanja", gjë të cilën ai e kish miratuar menjëherë, madje që me 2 janar, pa ardhur ende në Havani dhe braktisur nga Batista. Në këtë funksion Che ndenji deri më 12 qershor, e kjo ndoshta mbetet njolla më e errët në biografinë tashmë paradoksale, plot enigma dhe kapërcime ekstreme të Che, por edhe për këtë, do të kemi rastin të shprehemi më pas, kur të thellohemi në analizën e këtij personaliteti kontravers, që s'i shpëton dot përcaktimit si një anarko-terrorist i së majtës ekstreme revolucionare. U kombinuan nga fitimtarët gjyqe të ngjashme me atë të Nyrembergut dhe gjyqe popullore, ku jeta apo vdekja vendosej nga një 'Si' ose 'No' e turmës. Më pas Che u

mor me reformat, sidomos atë Agrare, që shtetëzoi tokën dhe shpejt u vu në krye edhe të dikasterit të Industrisë. Ka marrë kuptim gati anekdotik, emërimi i tij edhe në krye të Bankës Qendrore, kur Fidelit, në një mbledhje me drejtuesit kryesorë, befas lëshoi pyetjen për pjesëmarrësit se kush prej tyre ndihet ekonomist i mirë. Che nuk priti aspak dhe u përgjigj: "Unë". Fidelit, në cast e emëroi guvernator të bankës. Che, fjalën ekonomist i mirë e kish dëgjuar gabim, pasi iu duk se pyetja ishte, se kush ndihet komunikant i mirë.

Fidelit, që në fillim mbajti vetë vetëm titullin komandant, vuri në krye të shtetit si president Manuel Urrutia Leo-n (1901-1981) dhe kryeministër Jose Miro Kardona-n (1902-1974), personalitete liberale demokratë, por që shpejt i shkarkoi të dy. Të parin e zëvendësoi pas gjashtë muajsh me Dr. Osvaldo Dortikos Torrado (1919-1983, i vetëvrarë, pas 17 vitesh president dhe 6 vitesh guvernator i bankës), kurse të dytin, vetëm pas gjashtë javësh, duke u bërë vetë edhe kryeministër. Urrutia emigroi në SHBA dhe Kardona në Porto Riko, deri sa vdiqën. Tani Fidelit, komandant suprem, çuditërisht i vetëgraduar major, i beson Che një sërë turesh diplomatike, i pari nga të cilët nis më 12 qershor 1959 nëpër 14 vende të Paktit të Bandungut, përfshi Japoninë dhe Indonezinë, ku edhe u prit respektivisht nga perandori Hiro Hito e presidenti Ahmed Sukarno. Të tilla ture, ai i ndërmoi në Europë, Azi, Afrikë dhe Amerikën Latine, ku mori pjesë dhe foli edhe në Konferenca Ndërkombëtare, si në Punta del Este të Uruguait, Algjer, Gjenezë, apo edhe në sallën plenare të Pallatit të Qelqitë, të Asamblesë së Përgjithshme, në Nju Jork. Të dyja këto të fundit në OKB (25 mars, e 11 dhjetor 1964-ës ku dhe iu bë një atentat i dëshatur prej kundërvolucionarëve kubanë).

Che vizitoi Bashkimin Sovjetik të paktën tri herë, Kinën, Indinë, Egjiptin e vende të tjera në të katër kontinentet, duke u takuar me Maon, Nehruin, Hrushovin, Naserin, Titon, Ho Shi Minin, Kim ir Senin dhe shumë lider të tjerë, deri dhe Mehmet Shehun në Tiranë, për të cilin do zgjatemi më pas, për shkak të diskutimit që ka ngjallur kjo vizitë dhe ky takim në këto gati 30 vite.

Pas një ture të ri në Afrikë, Che kthehet më 14 mars 1965 në Kubë dhe e gdhin natën me Fidelin, ku diskutojnë për projektin guevarist të eksportimit të revolucionit, por çuditërisht nuk shfaqet në publik. Ngjarje të rëndësishme, që nuk mund të mos përmenden, kanë ndodhur më parë. Kështu kemi rebelimin e parë popullor antikastrist në Camaguey, korrik 1959, për të cilin Kastro fajësoi liderin Huber Matos Benitez (1918-2014), lider e shkrimtar i shquar, që pas kundërshtimit të fortë për reformat

dhe shkarkimin e presidentit Urrutia, (i dërgoi edhe dy letra Fidelit), pati kontradikta të ashpura me Raul Kastro-n dhe Che, u arrestua dhe u dënua me vdekje, nga e cila e shpëtoi po vetë Fidelit, ngaqë nuk dëshironte ta kthente në martir këtë disident, duke e burgosur plot 20 vjet (1959-1979). Për më tepër, pas "dëshmive" të Raulit dhe Che në gjyq, për shtatë orë rresht dëshmoi edhe vetë Fidelit! Interesant mbetet fakti se, arrestimin e tij e bëri një 27-vjeçar, komandanti i shquar Camilo Cienfuegos, një lloj kaçaku e kaubojsi ekstremist, i cili gjatë kthimit për në Havana, humbi jetën në një aksion ajror me Cesna, ende të pa sqaruar deri në fund. Matos u akuzua edhe si agjent i CIA-s, për tradhti të lartë bashkë me Pedro Luis Diaz Lanz në ngjarjet e Gjirit të Derrave ose Plazhit Zhiron (kur zbrakuan 1400 forca invaduese dhe Che komandon me sukses operacionin kundër zbrakuesve) etj.

Ai u burgos në fillim në Burgun Isla de la Juventud (ku që burgosur dikur Fidelit) dhe më pas në Kabanja. Pas burgut të gjatë e të rëndë plot dy dekada, emigroi në SHBA, ku edhe vdiq në moshën 96-vjeçare. Diktatori dominikanas Truhajo ofron asistencë për Legionin Antikomunist të Karaibeve, plot me kundërvolucionarë kubanë e të huaj. I kësaj kohe (4 mars 1960), është edhe eksplozioni në portin e Havana-s i fregatës franceze 4310-tonëshe, "La Coubrre" ngarkuar me municion belg në Portin Antwerp, që shkaktoi rreth 100 të vrarë e gati 200 të plagosur, ku Che ndihmon pa u kursyer për të shpëtuar jetë njerëzore në drejtim të operacionit. Ndër të akuzuarit kryesorë për masakrën ishte dhe amerikan William Aleksander Morgan, që arrestohet gjashtë muaj më pas, gjykohej dhe ekzekutohej. Më 3 janar 1961, SHBA presin marrëdhëniet diplomatike me Kubën dhe më 3 shkurt 1962 shpallin embargon ndaj saj. Kriza mbërrin kulmin në tetor të këtij viti, me zbythjen e turpshme të Hrushovit, që tërhoqi raketat balistike bërthamore sovjetike nga Kuba, të cilat rrezikonin një luftë botërore atomike, çka shënoi një fitore të madhe të Kenedit.

Me interes është edhe raporti i Che me Haydee Tamara Bunke Bider, e njohur më shumë me emrin Tanja Guerrillierja, lindur më 1937, bijë e një komunisti gjerman, Erich Bunker dhe ruso-polakes Judia Nadia Bider, të ardhur në Argjentinë më 1935 pas përndjekjes nga nazistët (mund të ishin me origjinë hebreje). Ata u takuan dhe u miqësuan në Republikën Demokratike Germane, gjatë një vizite të Che aty, ku ajo bëri dhe përkthyesen e tij në gjermanisht. Tanja i bashkëngjitet atij në aventurën e ndërmarrë për


eksportimin e revolucionit dhe vritet duke luftuar më 31 gusht 1967 në Vallegrande, vetëm 40 ditë para se të dorëzohet i plagosur; e më pas të ekzekutohet edhe vetë Che.

Më 1 prill 1965, Che i bën një letër lamtumirë Fidelit. Këtu ka dy pika të errëta. E para, ato që ai i shkruan në letër, pati mbi dy javë kohë t'ia thoshte personalisht me gojë Kastros dhe e dyta, si mund të shpjegohet që Fidelit e bëri publike letrën vetëm pas gjashtë muajsh, saktësisht më 3 tetor, gjatë punimeve të Kongresit Themelues të Partisë Komuniste të Kubës? E lexuar me vëmendje, në disa pika, ajo na kujton letrën e lamtumirës që Mehmet Shehu la për Enverin, para se ta vetëvritim, në mesnatën e errët të 17-18 dhjetorit 1981, e natyrisht kjo thjeshtë është vetëm një koincidençë.

Tani Che ka marrë vendimin t'i hyjë një aventure të re dhe mjaft të rrezikshme, duke u nisur drejtë Kongos, në pamje dhe në dokumente transformuar mjeshtrërisht nën emrin Ramon Benitez, me idenë dhe bindjen e palëkundur, se rruga Kubane do të ishte e suksesshme edhe në Kongon Belge postkoloniale (Zaire) të trazuar; aq më tepër që ajo ziente nga konfliktet mes palëve, ku nga një anë kishin qenë Lumumba (i vrarë më 1961) dhe Gizenga, e nga ana tjetër; Tshombe, Mobutu e Kasa-Vubu. Ai mbërrin atje në krye të një grupi mikso kubano-afrikan në 24 prill 1965 dhe merr kontaktet e para me rebelë gjysmë komunistë të tipit Kabila (i cili u instruktua më vonë edhe nga ushtarakë shqiptarë në Tiranë), por shpejt u zhgënjyer prej tij dhe nuk ia doli dot me forcat e Mobutus, këtij diktatori delirant e paranojak të pakrahueshëm, abuzues super i korruptuar i pushtetit dhe financave, kleptokrat e nepotist! I quajtur që kur lindi me emrin Zhozef Desire Mobutu, ai u mbi-quaj plot mburrje Mobutu Sese Seko Nkuku Ngbendu Wa Za Banga, që mund ta shqipërojmë si Luftëtar i Plotfuqishëm, Këmbëngulës i Pandalëshëm nga Fitorja në Fitore, që mbrapa lë vetëm zjarr! Kështu Che, pasi dështoi me sukses të plotë, i dërgon nga Afrika nën pseudonimin Tatu, një letër të dytë plot pesimizëm Kastros.

Nga përgjigjja e tij kuptohet se Fidelit nuk ka predispozitë të indestohet, apo të vazhdojë t'i dërgojë ndihma, madje del qartë se ai është për kthimin e tij. Kështu, më 21 nëntor, me kokën ulur, largohet nga Kongo, si e pranor edhe vetë në ditar... "Pas një historie të mbyllur me dëshitim...", e nga Dar Es Salaam i Tanzanisë (ku bëri një tentativë të fundit, pa mundur t'i bindë, për projektin luftarak të tij në Afrikë, përfaqësues të FRELIMO-s, Lëvizja për Pavarësi e Mozambikut, siç dëshmoi më vonë në Havana. Major Juan Almeida, në rolin e Ministrit të Forcave të Armatosura), Che udhëton në klandestinitet për në Pragë e më pas edhe në disa vende të tjera. Këtu ka disa pika të errëta, ku shkoi dhe kë takoi, por një gjë është e sigurt; ai pati një takim në fshehtësi të plotë me ish-presidentin argjentinas, Juan Peron (që jetonte në Spanjën frankiste), i cili e quajti vetëvrasja planin utopik të Che, nga i cili duhej hequr dorë menjëherë. Por koha tregoi se Che nuk i konsideroi këshillat e urta të tij dhe u nis në rrugën pa kthim drejt fundit të pashmangshëm, ndaj dhe i hipi avionit për t'u kthyer fshehurazi në Kubë, në dhjetor të 1965-ës. Kjo që edhe hera e fundit e pranisë së tij në ishull, ndërsa ende mbetet e errët, nëse ai e takoi, apo jo Fidel Kastros.

(vijon nesër)



Opinion i Ditës

Në barkun e balenës

Nga Valbona Nathanailli

(vijon nga faqja 1)

... se çdo person është në gjendje të sjellë ndryshimin dhe ta bëjë vendin e tij shumë, shumë më të mirë: "Një amerikan ka mundësinë të takojë dhjetë mijë njerëz gjatë gjithë jetës. Nëse secili nga ne ka mundësinë të ndryshojë jetën e vetëm dhjetë personave, dhe secili nga këta të dhjetë, ndryshon jetën e dhjetë të tjerëve - vetëm dhjetë - atëherë përgjatë 125 viteve, do të kemi ndryshuar jetën e 800 milionë njerëzve!"

Por jo të gjithë besojnë në ndryshimi nëpërmjet fjalës dhe te ndikimi që përçon ajo. Nëse lexon komentet që u bëhen artikujve të ndryshëm të botuar në mediat e portalet e shumta, nuk mungojnë komente të tipit: Pse shkruan? Kujt i flet!? Askush nuk të dëgjon!

Duket se efektet psikologjike të të jetuarit për një kohë të gjatë në një vend si i yni, me korrupsion, shitblerje vote dhe trafik parimesh, ku flitet për besën, por besë ka më shumë shitësi i domateve me hormone se sa pronari i një institucioni arsimor, kanë çuar në krijimin e një ndjenje shtypjeje dhe mungese dialogu, si dhe të një lloj mosbesimi ndaj fjalës së lirë, institucioneve dhe njerëzve që udhëheqin, pushtetarë a të zgjedhur qofshin dhe, të gjitha bashkë, në kultivimin e së ashtuquajturës "kul-



turë e autocensurës". Fjala nuk është më e para!

Kjo kulturë autocensure, pavarësisht mënyrës se si paraqitet, naive ose jo, e paqtë ose jo, agresive ose jo, po forcohet përditë e më shumë dhe po ndikon, drejtpërdrejt, në ushtrimin e një censure edhe mbi të tjerët për të mos folur nën moton "Për kë po e thua!" Duket sikur jetojmë në barkun e një balene, njësoj si Xhepeto të "Pikniku" i Kolodit! Në errësirë e të

nënshtuar ndaj fatit, ushqehemi me mbeturinat e stomakut të kafshës së frikshme dhe ndriçohemi nga dhjami i saj, ndërsa shpëtimin e presim nga jashtë.

Nëse jemi të zhgënjyer nga politikanët, nga drejtimi i vendit, nga rruga që ka marrë zhvillimi, atëherë zgjidhja është të fuqizimi i institucionit të fjalës së lirë, të mendimit ndryshe, të shtimit të ndikimit. Nuk mund të thuash se jam edhe i lirë, edhe i vetëcensuru-

ar: se jetoj në demokraci, dhe nuk kam besim te forca e fjalës dhe ndikimi që ka ajo.

Pak... është më mirë se asgjë, thonë anglezët. Të flasësh... është më mirë se të heshtësh! Dështimi ose sukcesi i demokracisë varet nga mundësia që u japim njerëzve që mendojnë në mënyrë të pavarur. Dështimi ose sukcesi i demokracisë varet nga përkrahja dhe besimi që u ofrojmë njerëzve që kanë aftësinë të përmirësojnë

cilësisht opinionin e përgjithshëm publik të thonë fjalën e tyre, nga përpjekjet e të gjithëve për të krijuar një shoqëri qytetare dhe të ditur. Nuk mund të pretendojmë se po ndërtojmë një shtet demokratik, nëse shoqëria nuk është demokratike. Shoqëria nuk bëhet demokratike duke zhvilluar autocensurën dhe kultivuar censurën, por duke besuar në disa vlera të përgjithshme dhe një nga këto është besimi te artikulli i të vërtetave.

Fenomeni merr përmasa të mprehta në shoqëri kur një masë e madhe qeniesh njerëzore nuk kanë arsimimin dhe edukimin e duhur. Në raste të tilla, shprehej njëqind vjet më parë Giddings, shumica (lexo demokracia) vërtet pohan politikën e liderëve të zgjedhur, por kjo nuk do të thotë se ata punojnë detyrimisht në interes të saj.

Demokracia vërtet është hipokrizi, shprehet Orwell, por sado hipokrite të jetë, janë disa vlera të të cilat duhet të kemi besim. Për anglezët, patriotizmi shërben si një fije lidhëse për të gjitha shtresat e shoqërisë, njësoj si mblidhet tufa e bagëtive kur i duhet të përballlet me ujkun. Koncepte si drejtësia, liria dhe e vërteta objektive vërtet mund të jenë iluzione, por janë iluzione të fuqishme dhe të të cilat duhet të vazhdojmë të besojmë. Dhe padyshim të flasim në emer të tyre!

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



VIP

Suplement
Pages

E mërkurë 24 Tetor 2016 GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Bjeshkët e Nëmura, Saimir Tahiri publikon foto me shokun e ngushtë
- Meghan përkëdhel barkun, Harry: Shpresojmë të jetë vajzë
- Deputetja e PD: Vij nga profesion i qetë, s'rri dot me kriminelë në parlament
- Një pije me gaz, piktura e Trump me ish-presidentët republikanë

"Është marrëzi! Më ka prishur ditën!"
Revoltohet Olta Gixhari



Plastika të bën binjake!
Zbulohet sozia e Luana Vjollcës



U përfol ndarja me DJ Sardin, flet balerina:
Largimi ishte një tundim i madh



Rrëfëhet Jora Hodo: Sfidë ime e madhe, larg familjes dhe dashurisë

"Përfshihem e gjitha në punë dhe nuk i urrej kurrë mëngjeset e ditës së hënë"

U përfol ndarja me DJ Sardin, flet balerina: Largimi ishte një tundim i madh

Rrëfihet Jora Hodo:

Sfida ime e madhe, larg familjes dhe dashurisë

"Përfshihem e gjitha në punë dhe nuk i urrej kurrë mëngjeset e ditës së hënë"

Pamela Aliaj

Para disa kohësh u përfol shumë gjatë fakti i ndarjes së DJ të njëjtit dhe të dashur për shqiptarët, Sardi me balerinën bukurshë, Jora Hodo. Edhe pse ky ishte një lajm që erdhi nga shoqëria e tyre, asnjëri prej tyre nuk desh të prononcohej për median rozë. Por jashtë këtyre tablove të ndarjes apo bashkimit, kush është balerina bukurshë Jora Hodo? Në një intervistë ekskluzive për "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare", Jora ka folur për eksperiencën e saj të re jashtë vendit. Ajo gjithashtu na ka rrëfyer se pse zgjodhi të largohej nga Shqipëria për të ndërmarrë një rrugë të re jashtë vendit. "Është sfidë e madhe të qenit larg familjes, miqve dhe dashurisë, megjithatë..." Për më tepër në intervistën e mëposhtme.



Prej kohësh ndiqni baletin si profesion dhe pasion në skenë. Si lindi dëshira për të kërcyer?

Fillimet e mia kanë qenë në grupin "Millenium", në Pallatin e Pionierëve, në moshën 3-vjeçare. Nuk ka qenë dëshira apo pasioni im, por i prindërve për të më bërë një fëmijë social dhe jo i llastuar. Por me kalimin e viteve, baleti u bë pasioni dhe dashuria ime më e madhe, duke mos u shkëputur më, me vendosmërinë se kjo është ajo çfarë doja për të ardhmen time.

Jashtë kuintave jeta e Jorës lidhet sërisht me baletin, apo ka ndonjë pasion të dytë?

Ju mbase prisni një përgjigje që pasionet e mia janë fitnesi, palëstra, vrapi apo ndonjë lloj sporti tjetër; por jo. Pasioni më i madh është ushqimi (gastronomia) (qesh). Është gjëja e parë që shijoj pa masë pas punës, sidomos ëmbëlsirat. Tentoj shpesh të përgatis në shtëpi pjatat që më pëlqejnë. Me këtë rast i bëj qejfin dhe mamit (qesh). Përveç kësaj, një nga gjërat që më pëlqen më shumë janë erëzat dhe aromat ekzotike. Gjithmonë kam dashur të koleksionoj apo të hap një dyqan të vogël me çajra nga gjithë bota. Ndoshta si një farmaci çajrash naturalë në të ardhmen. Dhe mes shumë pasionesh jam e dashuruar mbas njohjes së kulturave të vendeve të ndryshme. Të udhëtoj, e dhënë pas arkitekturës së qyteteve të vjetër. Dhe pa diskutim, e dua shumë natyrën. Lidhja e një-

riut me natyrën është burim lumturie. E dua tokën me çdo gjë të sajën dhe mendoj që është parajsja ku jetojmë, por nuk dimë ta mbajmë.

Cila ka qenë pika më kulminante e Jorës në profesion?

Kam pasur fatin të provoj dhe shijoj shumë vende pune dhe kontrata duke filluar nga TV "Klan", "Top Channel", "Vision Plus", duke përfunduar në teatrin e Operës dhe Baletit. Para se të largohesha, isha pjesë e shumë projekteve, ku dhe fitova një kontratë pune. Nuk jam në gjendje të veçoj dot. Për mua të gjitha kanë qenë një mundësi e shkëlqyer. Më kanë rritur profesio-

alisht dhe emocionalisht. Kam marrë dhe mësuar shumë.

Cila është muza që ndiqni çdo ditë?

Nuk kam një muzë. Kam shumë njerëz, të cilët i çmoj për punën që bëjnë. Njerëz që kanë sens individualiteti brenda punës së tyre, kanë ekspresion. Çdo lloj ndjenje që është reale, që japin shpirtin në atë që bëjnë. Këta njerëz janë muzë dhe frymëzim për mua.

A kenë pasur pika ku kenë dyshuar nëse do të vazhdoni në këtë rrugë ose jo dhe cila ka qenë ajo?

E mendoj çdo fund muaji sa herë mbaron rroga (qesh). Bëj shaka.

Mendoj që hyj te njerëzit me fat, se bëj punën që dua. Jo të gjithë e kanë fatin të kenë për pasion punën e çdo dite, pa harruar pastaj që është një nga profesionet më të bukura. Ti shkon në punë dhe përfshihesh e gjitha emocionalisht, fizikisht, mendërisht dhe nuk i urren kurrë mëngjeset e ditës së hënë.

Nëse s'do të ishit balerinë, ç'do të zgjidhnit të bëheshit?

Me siguri, ose inxhinieri mjedisi, ose do isha bërë një kryetare bashkie shumë e mirë. Duke qenë se i dua shumë kulturat e vendeve dhe jam e dashuruar me arkitekturën e çdo qyteti, do ruaja me fa-

natizëm çdo pjesë të qytetit që dëshmon vjetërsi dhe origjinalitet. Kur aq sa do gjithë madhësinë e një qyteti, të punosh fort për të parë njerëz që ashtu si ti, e duan qytetin ku jetojnë dhe japin më të mirën e tyre për t'u zhvilluar bashkë me të.

Balerinë lind apo bëhesh sipas Jorës?

Shprehja e parë që kam dëgjuar në shkollë dhe që më ka ndjekur gjatë gjithë jetës është se baleti është si formulë matematikë, 99% punë dhe vullnet plus 1% talent.

A kenë ndonjë projekt së fundmi për të cilin jeni duke punuar?

Po. Prej dy muajsh po punoj në





Ajo është një prej aktorëve më të dashur dhe më të komentuar në 'showbiz'-in shqiptar. Është gjithnjë e lidhur me rrjetet sociale, duke postuar foto të ndryshme, fansave të saj. Por së fundmi ajo ka publikuar në profilin e saj në "Instagram" një video, ku ka lajmëruar se emri i saj është i përfshirë në një skandal, pasi është përmendur si përfutuese e financave të fshehta greke që funksionojnë në Shqipëri. Lidhur me këtë ngjarje, Olta ka njoftuar se do të flasë nesër në emisionin "Opinion". Madje, ajo është shprehur se do ta paguajë këtë, kushdo që e ka bërë. "Është një marrëzi që më ka prishur ditën! Dikush do mbajë përgjegjësi për këtë shpifje të rëndë kundër emrit tim. Nesër, një deklaratë më e gjatë në "Opinion", shkruan Olta, bashkëngjitur e videon e publikuar në "Instagram". Të shohim ç'ka për të thënë aktorja sot në media.

ku shpeshherë tërheq vëmendjen e fansave të saj. Por së fundmi ajo ka publikuar në profilin e saj në "Instagram" një video, ku ka lajmëruar se emri i saj është i përfshirë në një skandal, pasi është përmendur si përfutuese e financave të fshehta greke që funksionojnë në Shqipëri. Lidhur me këtë ngjarje, Olta ka njoftuar se do të flasë nesër në emisionin "Opinion". Madje, ajo është shprehur se do ta paguajë këtë, kushdo që e ka bërë. "Është një marrëzi që më ka prishur ditën! Dikush do mbajë përgjegjësi për këtë shpifje të rëndë kundër emrit tim. Nesër, një deklaratë më e gjatë në "Opinion", shkruan Olta, bashkëngjitur e videon e publikuar në "Instagram". Të shohim ç'ka për të thënë aktorja sot në media.

**"Është marrëzi! Më ka prishur ditën!"
Revoltohet Olta Gixhari, pas skandalit me
fondet e fshehta greke**



Bukuroshja Luana Vjollca është një nga moderatoret shqiptare më të dashura për që numëron një numër të madh fansash që e kanë model frymëzimi dhe jo vetëm. Shumë prej tyre do donin t'i ngjanin si në pamjen e saj fizike, ashtu dhe në elokuençen e natyrshmerinë e saj në punë. Nderkohë, është zbuluar sozia e saj dhe kanë një ngjashmëri të frikshme. Nuk dihet si do të ndihet Luana kur të shohë se ka dikë që ngjan thuasht identik me të. Dalimi mes dy vajzave është ngjyra e flokeve dhe dukeshin të dyja para ndërhyrjeve.

**Plastika të bën binjake! Zbulohet
sozia e Luana Vjollcës**



një kompani të zhanrit 'musical'. Cila ka qenë performanca më e mirë që ju ka mbetur në mendje? E shijoj çdo moment në skenë. Në fakt, pas çdo interpretimi, marr një ndjesi të papërshkrueshme, për të cilën ia vlen të punosh çdo ditë. "Je suis malade", tek "Dance With Me", me Drinin dhe Violën, është kërcimi që më erdhi në mendje tani. Një nga emocionet më të bukura të mijat në skenë.

Cila është pika ku Jora mbështetet gjithmonë dhe e quan forcën e saj kryesore?
Absolutisht në Zot dhe tek familja.

Si nisi rrugëtimi në "Vizion Plus"? A ka pasur momente që donit të largoheshit dhe pse?
Ishe diçka e paplanifikuar në "Vizion Plus". Një kontratë e vendosur shpejt, me një propozim si fillim nga mikesha ime, balerina Olta Ahmetaj, pastaj duke komunikuar me produksionin.

Së fundmi është përfolur për largimin tuaj jashtë vendit për një

kontratë pune. Si erdhi propozimi dhe si vendoset të pranoni?
Prej dy muajsh jam në një tur që përfshin disa vende të Amerikës Latine si Brazili, Argjentinë, Uruguai e të tjerë. Po ashtu, disa vende të Europës Perëndimore, si Francë, Portugali dhe Spanjë. Nuk ishte një propozim në fakt, por një audicion i fituar në fillim të muajt prill. Vendi? Një tundim i madh, përveç faktit një eksperiencë që jam e sigurt që do ndikojë shumë tek pavarësia ime si femër për të bërë përpara. Është sfidë e madhe të qenit larg familjes, miqve dhe dashurisë, ku për çdo problem, vështirësi apo vendimarrje për t'u mbështetur, ke vetëm veten tënde. Megjithatë, fakti që do kem mundësinë të njihem me kulturën dhe jetën e çdo vendi që do shkoj, më bën më entuziaste për këtë mundësi të re.

A keni pasur edhe propozime të tjera që i keni refuzuar? Pse?
Propozime për t'u shkëputur nga Shqipëria s'kam pasur. Ky ishte i pari.



Jo më larg se në fund të verës u përfol gjatë ndarja e kengëtarit të njohur Seldi Qalliu me kengëtarën Mimoza Shkodra. Të dy nuk deshen të jepnin arsye për këtë situatë, duke kaluar me postime pozitive dhe heshtje. e "shoe"-t të njohur, "Dance with me" ku në krah ka një partnere tepër simpatike. Por, së fundmi kemi venë re se partnerja Robert Berishes në show, Lei Kraja ka përfunduar në krahët e Seldit. Ka qenë vetë Seldi, ai që e ka publikuar një foto, të cilën e ka marrë nga "Instastory" i Leilës. Të dy dukeshin shumë të lumtur pranë njëri-tjetrit. Të jenë vetëm shokë të mirë? Konkurrënca në 'show' nuk shihet aspak jashtë dyerve të "Klan". Të shohim kush do ta rrembejë kupën në fund.

Së fundmi, Seldi është bërë pjesë e "shoe"-t të njohur, "Dance with me" ku në krah ka një partnere tepër simpatike. Por, së fundmi kemi venë re se partnerja Robert Berishes në show, Lei Kraja ka përfunduar në krahët e Seldit. Ka qenë vetë Seldi, ai që e ka publikuar një foto, të cilën e ka marrë nga "Instastory" i Leilës. Të dy dukeshin shumë të lumtur pranë njëri-tjetrit. Të jenë vetëm shokë të mirë? Konkurrënca në 'show' nuk shihet aspak jashtë dyerve të "Klan". Të shohim kush do ta rrembejë kupën në fund.

**Ndarja mbeti pas krahëve, por kush është
bukuroshja krah Seldi Qalliu?**

BULEVARDI

Na merrni seriozisht!

POLITIK



Bjeshkët e Nëmura, Saimir Tahiri publikon foto me shokun e ngushtë

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri ka publikuar një foto në rrjete sociale, ku e shohim në Bjeshkët e Nëmuna. Por, në këtë udhëtim Tahiri nuk ka qenë vetëm, por me djalin e tij, Drinin. Në foton e publikuar nga Tahiri, ai shfaqet i përçafuar me të birin dhe krahas fotos shkruan: "Me shokun tim të ngushtë". Këto kohë ish-ministri po kalon mjaft kohë me djalin e tij.



Meghan përkëdhel barkun, Harry: Shpresojmë të jetë vajzë

Princi Harry dhe Meghan njoftuan shtatzëninë teksa mbërritën në Australi. Gjatë një fjalimi në Sidnei, Princi Harry ka dhënë edhe disa indicie për shtatzëninë e Meghan. "Përpara se gjithave ju falënderoj për mikpritjen - ka thënë Harry - jam kaq krenar që po ju prezantoj bashkëshorten time dhe jemi shumë të lumtur të festojmë me ju gezimin e shtatzënisë". Kur një grua nga turma ka thirrur: "Shpresojmë të jetë një vajzë", Harry është përgjigjur: "E shpresoj edhe unë". Harry dhe Meghan kanë zbritur në Fraser Islans, ai ka marrë pjesë në kërcimin e mirëseardhjes, ajo ka marrë disa orë pushimi për t'u relaksuar. Më pas ajo i është bashkuar bashkëshortin në Kingfisher Bay. Atje shkëmbejnë shikime të ëmbla, i mbajnë dorën njëri-tjetrit, teksa dukeshin e Sussex përkëdhel gjithmonë e më shumë barkun e saj. Ai i emocionuar e sheh pa ia ndarë sytë.

Deputetja e PD: Vij nga profesion i qetë, s'ri dot me kriminelë në parlament

Deputetja e PD-së, e dyta në listën e qarkut të Tiranës, Orjola Pam puri ka bërë një deklaratë të habitshme gjatë një interviste televizive, teksa ka thënë se vjen nga një profesion i qetë dhe si e tillë s'mund të rrijë në parlament me persona të lidhur me krimin. "Jemi në një bojkot dhe ende nuk është vendosur se kur kthehemi në parlament. Ne do të kthehemi atëherë kur parlamenti të pastrohet nga personat e përfshirë në krim, pra ata që bashkëpunojnë me krimin. Është e pamundur që të vish nga një profesion i qetë dhe të rrih me persona që bashkëpunojnë me krimin, totalisht e papranueshme", u shpreh deputetja demokrate.



Një pije me gaz, piktura e Trump me ish-presidentët republikanë

Një pikturë e presidentit aktual të SHBA-ve, e vendosur në një faqe muri në Shtëpinë e Bardhë. Vepra e artit u pa nga teleshikuesit gjatë intervistës që presidenti dha për televizionin "CBS", në emisionin "60 Minuta". Më konkretisht, kur një plan i gjere e shfaq duke diskutuar në një zyrë të Shtëpisë së Bardhë me gazetaren. E varur në mur pas kurrizit të tij, piktura e paraqet të mbështetur në një tavolinë bari me ish-presidentë të tjerë republikanë, si George W. Bush, Richard Nixon, Ronald Reagan, Gerald Ford, Abraham Lincoln e tjerë. Kjo botë e vogël të krijon përshtypjen sikur bisedon rreth një gote (një pije me gaz për Donald Trump, i cili nuk e konsumon), në harmoni me të tjerët dhe humor të mirë.



Studentët e Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin "Luarasi", dje në burgun 313



Avokati dhe pedagogu Saimir Vishaj: Bashkëpunimet me institucionet do të vazhdojnë

Voltiza Duro

Studentët e Universitetit "Luarasi", vizitë në burgun 313 në kryeqytet

Ethem Ruka: Merrni vendime të drejta në të ardhmen

Studentët e Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin "Luarasi" vizituan të paraburgosurit në burgun 313 në kryeqytet, për të parë e prekur nga afër realitetin në këtë institucion. Në kuadër të kombinimit të teorisë me praktikën, studentët biseduan me të paraburgosurit, dëgjuan shqetësimet e tyre, madje dhanë këshilla profesionale për zgjidhjen e çështjeve. Përvoja e ofruar nga ky institucion elitar synon përgatitjen e juristëve profesionistë në tregun e punës. I pranishëm në këtë diskutim ishte edhe drejtori i burgut 313, Maksim Hamiti, i cili i uroi studentëve të Drejtësisë në "Luarasi" suksese në rrugëtimin e tyre si juristë të ardhshëm dhe i këshilloi të tregohen sa më objektivë e profesionistë në marrjen e vendimeve në sallat e gjyqit. "Ju uroj suksese në punë tuaj shumë fisnike. Ju do të dini të mos niseni nga pasioni për vendimin që do të jepni, po të mateni dhe të jepni vendimin e duhur. Këta presin drejtësi", - tha Hamiti.

EKSPERIENCA

Rektori i Universitetit "Luarasi", prof. dr. Ethem Ruka në fjalën e tij tha se kjo eksperiencë do të shërbejë si një vlerë për studentët në ushtrimin e profesionit në të ardhmen. "Për studentët tanë është një gjë shumë e rëndësishme, sepse në mundohemi që në shkollë që ata që do bëhen juristë e së nesërme duhet të njohin realisht realitetin. Ju vajza dhe djem që do bëheni juristë mbajeni mend këtë ditë këtu. Kjo duhet t'ju lërë mbresa në ndërgjegjen tuaj, në ushtrimin e profesionit tuaj kur të bëheni juristë dhe ju do të keni të bëni me këto probleme që dëgjuat këtu. Dhe duhet të jeni të drejtë në marrjen e vendimeve, duke zbatuar ligjin dhe vetëm ligjin. Kjo është një përvojë e mrekullueshme dhe shpresoj që ju ta ktheni atë në një vlerë kur të formoheni si juristë", - tha rektori Ruka. Saimir Vishaj, pedagog i së Drejtës Penale në "Luarasi", një nga avokatët më të njohur në vend, theksoi se bashkëpunimi i universitetit me



Rektori i Universitetit "Luarasi", prof. dr. Ethem Ruka

institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale do të vazhdojë. "Si zakonisht, studentët e 'Luarasit' me atë moto që ne kemi, që prekim edhe teorinë, edhe praktikën duke i gërshtetuar të dyja bashkë. U takuam

me të paraburgosurit, për të cilët ne kemi një nga parimet bazë duke i prezumuar të pafajshëm. Studentët bashkëbiseduan me të paraburgosurit, është një ogur i mirë që ky bashkëpunim me institucionet



Saimir Vishaj, pedagog i së Drejtës Penale në "Luarasi"

ekzekutimit të vendimeve penale të vazhdojë. 'Luarasi' aktualisht ka një marrëveshje me të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe këta studentë sot, atë çfarë mësojnë në auditor vijnë e

prekin edhe në burgjet shqiptare", - u shpreh Vishaj. **STUDENTËT E DREJTËSISË**

Studentët e Drejtësisë në "Luarasi" ndihen tejet të kënaqur për mundësitë e shumta që ky universitet iu

ofron çdo ditë e më shumë. "Eksperiencia e ditës së sotme ishte sa profesionale, aq edhe emocionale. Falënderoj profesor Saimir Vishajn për mundësinë që na dha. Dhe një falënderim i veçantë për Universitetin tonë, 'Luarasi', tha një studente. "Ishte një eksperiencë shumë interesante. Ta kemi si bazë të asaj, që duhet të bëjmë kur të mbarojmë shkollën e të dalim në jetë", tha një tjetër student i "Luarasit". Në fund të takimit, studentët e Universitetit "Luarasi" dhuruan libra për të paraburgosurit në burgun 313. Aplikimi i praktikave të tilla dëshmon edhe njëherë se "Luarasi" vazhdon të mbetet një ndër liderët e arsimit të lartë në vend, me synim përgatitjen e profesionistëve të denjë në tregun e punës.

"CRCA Albania", kërkesë Kuvendit të Shqipërisë Hapet fushata "Voto 16", synon uljen e moshës së votuesve në zgjedhje

Organizata për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në vend, "CRCA Albania", hapi dje fushatën "VOTO 16". Njëpërmjet një peticioni të bërë publik mëngjesin e djeshëm, "CRCA" iu drejtua Kuvendit të Shqipërisë dhe të gjitha partive parlamentare, për të kërkuar uljen e moshës së votimit nga 18 në 16 vjeç. "CRCA Shqipëri", prej kohësh ka nisur konsultimet me adoleshentët dhe të rinjtë në të gjitha qarqet e vendit për këtë nismë. Në kuadër të mbështetjes së fuqizimit

të pjesëmarrjes të adoleshentëve dhe të rinjve në vendimmarrje, një ndër kërkesat më të shpeshta që është shprehur gjatë konsultimeve ka qenë ulja e moshës së votimit në 16 vjeç. Sipas vetë të rinjve, kjo do të fuqizonte jo vetëm pjesëmarrjen dhe përfaqësimin politik të adoleshentëve dhe të rinjve, por edhe vendimmarrjen e tyre në të gjitha proceset ku vendoset për ta. Shqipëria ka eksperiencë pozitive përsa i përket garantimit të së drejtës së votimit. Vendi ynë është ndër vendet e para në Europë, që iu njohu grave të

drejtën e votës, që në vitin 1920. E drejta e votës në moshën 16 vjeç njihet tashmë në shumë vende si: Austri, Gjermani, Amerikë, Skoci, Norvegji, Brazil, Argjentina, Zelanda e Re, etj. Altin Hazizaj, në emër të 'CRCA' në bërjen publik të peticionit tha: "Ne ftojmë të gjithë adoleshentët dhe të rinjtë në të gjithë Shqipërinë, prindërit, mësues dhe aktivistë të mbështesin Peticionin 'Voto 16', duke votuar në adresën www.crca.al/sq/voto-per-16", - thuhet në njoftimin e organizatës. Prej vitesh në Europë ka një sërë lëvizjesh



që kërkojnë uljen e moshës së votimit. Si Parlamenti Europian, ashtu dhe Këshilli i Europës po promovojnë përfshirjen e të rinjve dhe adoleshentëve në votime që në moshën 16 vjeç. Zhvillimi

mi i vendeve, aksesit në arsim, teknologji, vendimmarrje në komunitet dhe në shkollë i ka formuar adoleshentët mjaftueshëm për të marrë vendime për jetën, veten dhe interesat e tyre.

DATËLINDJA


Franceskanët zbulojnë pesë letrat e panjohura të Fishtës

Fatmira Nikolli

Çfarë shkruante nga Roma më 1925 frati, nga puna me "Lahutën", te botimi i Kanunit dhe kërkesa për duhan e raki

S i të thashë, kam fillue një kangë, që shpresoj se ka me mbetë nder më të bukura të Lahutës. Dër m'sod kam shkruë ktu n'Itali kater kangë të Lahutës; një Cantico drammatico më së dy mij vjershash; një Konferencë mbi Provincen t'onë e një satirë mjaft të gjatë. E pra Doktor! më ka pasë urdhnuë kater muj pushim menduer, posë trazimesh të mdhë që më qesin letrat shumë herë të papuna. I falem nderës Zotit, që kë kthye në Shkodër tii!"

Pesë letra të At Gjergj Fishtës janë publikuar për herë nga franceskanët. Pas daljes te numri i parë i "Hyllit të Dritës", "Gazeta Shqiptare" i sjell të plotë në bashkëpunim me "Botimet Franceskane" me rastin e 147-vjetorit të lindjes së poetit kombëtar (dje më 23 tetor). Nga bisedat personale me fretnit e tjerë, te bisedat për çështje me ndjeshmëri të veçantë për të e provincialin, ku flitet për ecurinë me "Lahutën e Malcis", botimin e Kanunit të Gjeçovit, a shkollimin e fretnëve në Itali. Dimensionit njerëzor e ai i njeriut të besimit, ndërthuren për të dhënë Fishtën e letrave, librave e shkresave, që teksta gjendej në Romë, kujdeset për fretnit e ri, për shkollat në Shkodër, për botimet e mbetura në mëshpesh kritikonte edhe veten për çka kishte lënë pa bërë.



Faksimile e një prej letrave të Fishtës

e emnit të vet me 26 Dhetuer. [...] asht vetem ktu, që na, tuj lutë Sh' Leonardin me 26 Dhetuer, pra mbas një mojit, kena pasë një gostë mjaft të mirë, ndersa kto urime të prapambetunës të Sh' Ambrozit as mue as ty s'po na qesin gjë m'skep. Po m'thue, se s'din shka me m'shruë. Po ti të m'kishe dhënë ndoj lajm mbi gjeje të Shkollës, të trupit msjojtjer, të zansave, do të m'kishe bënë njerë të madhe fort; pse, tue pasë kë në vetë msues e drejtuer per *dymdhetë* vjetë - janë 25, besa, por... nejtë - kam të madh dishir, me dijejt se si shkollat e Shkollës. Në paç ngaë pra ndoiherë me m'shkrue, mos m'shkruejt kurrigjëndet tjetër, në daç vetem punë shkollash, e kam me tu falë nderës.

lakna per akshihane, por pse nuk man zjarm e po m'duhet orë e ças me ndezë cingaren - Punë të mirë që kishi bā ti e P. Pali tuj m'marrë gjw' msen e cingareve, që kemi pasë në Bari!

Dje kemi shti në dhë në Pantheon mbretshen e Italis, Margariten. Varrimi asht bā me lumni të madhe. Prej Klerit kan kë në grishë vetem Franciskajt e Kapucijit, si kishte pasë metë doke kah mot në vorrim të gjindës s'dinastis Savoja. Freten kan kë në më 100. Kam kë në edhe vetë. Në ket rasë kam pā Diaz e Cadornen edhe Pipo Pappen e "Becco Giallo".

Detyren që kë të libratari Marietti kam me t'a pague në mos harroshta. Kā dekë Nikolla, deraxhija i kuvendit të ktushem. Lute Zotin per të mjerin, pse kā pasë kë në fort i mirë.

Jam tuj punue n' Lahutë të Malcis. Dër n'marim të ktij mojit shpresoj per do dit, e mandej eja prap. [...] Si t'a shof punen mā kjarjtë, kam me të shkruë prap mbi ket çashtje. Ktejt punët sikurë i kë lānë: makarona e fjalë të mdhā, sa me t'u nevertit. E merr mend, sa jam tuj e merzitet vetum. Me mzi pres ditën që me i nisë per Palermo, per me predikue novenen e Zojtës: veç si t'a kalojē kohen me ndoj punë per dore.

Falem me shndet të gjithve, emen per emen, shka asht Frat e ktudho që t'pvesë per mue.

shkrue! E pse masandej? Veç pse i kam shkruë Provlit [Provincialit], se aj kamen s'e kā të ligë. Tashti, un tuj e marrë me mend, se Provlit mund do t'a kndote at leter edhe para tij, a mund thojshë ashtu trūç, se kamës s'tij i kā ra pika, si P. Agustinit, dritë pasët, e se me kohë do t'i bjerë "qymja" "ma[draga]", "dala e gjās", "prijit" etr. etr.? Nejtë...

Tash, mjaft. U falem me shndet të gjithve në Kuvend e në Shkollë. Të marr ngrykë me shum mall.

P. Gjergji i yt

I dashtuni P. Provincial,
Kaluen dye të Merrkurre - dye ditë Poste prej Shqypnijet - e un prej tejet s'mora as leter as kartolinë, mos tjetër, sa me m'diftue se kenit mrrijitë shndoshë e mirë në Shkoder. Por kā pasë thānë i moçmi: si t'i bāsh kujt, t'a bājnë e t'a teprojnë; prandej, mbasi vetë jam i ngāhtët në të mbajtur të korrrispondencës pustollare me tjetër, s'kam tager me u zemrue pse tjetër nuk m'shkruejn.

Simini kā shkruë prej Livorno e difton, se e kā xjerrë pasaporten. Un i telegrafova në ket mndyrë: "Venite Roma quanto prima urgendo vostra presenza gimnasio francescano Scutari". I telegrafova në ket mndyrë, pse aj m'shkruejt, që do të shkote me giasë, në Leçe, per me pā familjen e Atiljas e të Gjacintos, të vllazenve të vet, e se masandej do të nisej per Shkoder - Tue kë në s'ktu n'Itali fillojē msimet gymnazjore në Ndanuer, aj kujton se kā kohë me u ndalë edhe ndonji ditë mā teper n' Itali - Dër sod enë s'kā ardhë në Romë. Do t'ia mushi mendem me u nisë sa mā para per Shqypni.

Ekspozicijoni kā me u mbyllë zyrtarisht me 24 të Dhetorit të k.v. Por, mbasi muzeu etnografik në pellaz papnuer të Lāteranit enë nuk asht gati e kshu Ekspozicijoni kā me u çilë vetem dye dit në javë, me personal të muzejtve të Vatikanit. Prandej nuk lānë që t'hiqen teshat, perpara se komisjoni i muzeut të ri etnografik të ketë caktue, se cillat teshat t'Ekspozicijonit lypen per muze. Si po shof puna do të shkojē gjatë. Un u kam thanë Ercolit e Nagarës, se argjantarin s'mund e bā kursrse mā teper se një vjetë e se domosdo do t'a nisi per Shkoder. Atā m'thānë: shko një herë në Shqypni per do dit, e mandej eja prap. [...] Si t'a shof punen mā kjarjtë, kam me të shkruë prap mbi ket çashtje.

Ktejt punët sikurë i kë lānë: makarona e fjalë të mdhā, sa me t'u nevertit. E merr mend, sa jam tuj e merzitet vetum. Me mzi pres ditën që me i nisë per Palermo, per me predikue novenen e Zojtës: veç si t'a kalojē kohen me ndoj punë per dore.

Falem me shndet të gjithve, emen per emen, shka asht Frat e ktudho që t'pvesë per mue.



Gjergj Fishta

P. Gjergj Fishta
P.S.

Kuer të keshë pare me shpenzue per mue, të lutem mi dergo tash e mā vonë kā një çerek kg cingaresh m'adresë: Legazione Albanese - Roma.

Fort i dashtuni P. Pāl!

Fort kam pasë dishrue me i kaluë Kshndellat me ty në Troshan; por Provinciali - per do arsye të vetat - po m'thotë, m'e lānë per një tjetër herë. Prandej s'po m'jet tjetër, veç me të thānë me leter: i gzosh per shum mot Kshndellat e motmotin e Ri. Dramin e Sh' Luigit e kam marue s'shkruejt e m'kā dalë mjaft i mirë e i gjatë; afer 1600 vjersha. Kā me u tfaqë me 16 Kallnduer 1927.

Tuj t'marrë ngrykë të falem me shndet tyë, P. Engllit e gjith tjetër.
P. Gjergj Fishta

Livorno, Fort i Nderti e i dashtuni Provincial!

Letra e Jote - me 10 të k.m. - më kā ngushllue fort, si pse asht mā e para mbas tre muejsh heshtimi, si edhe fort e mā fort per dy mrekullit e Shna Ndout që m'i lajmon në ket leter.

Per punë t'Iterit të Shna Ndout jam tue i shkruë sod P. [...], prandej ktu s'po të shkruëjt gjā të posaçme mbi të.

Në të mbyllun t'Akademis së Sienës shkova vetë atje, me vertetue me sw të mi perparimin e P. Leonit në Pikturë mundem me të thānë, se n'at rōd pikturë që ndiekë aj asht sugurisht mā i pari i klasës së vet. Si Drejtori i Akademis si Profatori i tij e kan levdue per cenë e perparim. Edhë un vetë jam konden me të. Ktu po të qes dy fotografi punimesh së tija e të shenjueme me siglat A e B. Fotografija A) paraqet një të katert të tavanit. Leoni kā pikturue në një odë t'Akademis. Si ravizimi si ekezkutimi me bojna janë fort me



vend. Në fotografimin B) janë të rreshtueme punimet, qi krye rrokul vjetit n' Akademi. Drasëzat n'nyrje murrte jane punue "a fresco" nder- sa ato të bardhat me "carbonçioni".

Ajo e mjedisnjia - "Maternità" është punimi ba per provinim e mbramë të vjetit shkolluer, e është sugurish ma e bukra nder të gjitha punime të ktij subjekti paraqitë nder sprovime - Ndoshta, në mos [...] "createare", ka me dalë sigurisht nji ekzekutore i mirë. Ky ka kryë s'vijet të tretin kurs akademik e do të rrijë edhe dy vjet në Sienë, per me krye plotsisht kursin akademik t'asajë Shkolle e me marrë diplomën per piktur. Un jam mendimi me e lënë me vijue, mos t'jetër, edhe per dy vjet Pikturën - Mjerisht është i mberthyem teper me sherbime të Kuvendit.


P. Agostini ka dhënë tri sprovime n'Univerzitet, e të katerin gjihen tedeshke - në Tetuer - Nder tri sprovimet e bame, per dy ka marrë notën ma të nalten: "30 can lode", e per të tretin 24 - italish.

Edhë do Freten të ri, qi ndjekin Univerzitetin, e levdojnë fort per kah zotsija në kndime.

Si P. Agostini si P. Leoni kishin me dashhtë me ardhë në Shqypni kah gjysma e Shtatorit. P. Leoni kishite me i u dashhtë me shkue në Venezia, per me pa ekspozicionin e Pikturës; e atw kishite me u ba me P. Agostinin e të dy bashkë, me vaporr me ardhë në Shqypni. Prandë, të lutem me i a xjerrë Leonit obedjencen per Venezia e - po s'pate ti gjà kundra - të dyve vetë per Shqypni. Sa per ridukcion shprehzimesh në vaporr; tash po interesohem vetë - E meritojnë.

Sa per punë të botimit të libravet të mi fjalët i kam të mira; palë si do të më dale puna. Me pasë per t'i botue ktu n'Itali m'nji leter gati si ajo e Kanunit, librit kishite me i rà per kopë, me gjith transport, Lit. 5.00. Të 7 blëjt, kund 300 faqesh, kishin me u botue mbrenda 7 muajve. Po u ba puna me i botue, na

147-vjetori i lindjes/ "Përktimi i Kanunit kà randsi të madhe, nji mij biblijoteka t'Europës kishin me e blë"



Faksimile e një prej letrave të Fishtës

bjen fort mirë me i botue ktu n'Itali - Kaq kishite me ba lkura; por është halli se harusha [...] n'm'al...

P. Pali më shkruen, se perkthimin e Kanunit mendon me e ba në bashkupunim me Toçin. Bani si të dueni, por un nuk jam i ktij mendimi. Përktimi i Kanunit kà randsi të madhe, e nuk shof arsyes pse t'a perziejm Toçin në ket çashtje. Sugurish, pak me thënë, nji mij biblijoteka t'Europës kishin me e

blë, posë atyne t'Amerikës, të Japani etr. Në mos dashhtë me e perkthye P. Pali shkruaj P. Bazilit, pse sugurisht aj e perkthen tash (vakanca)sh; me niñmen e P. Marinin të të Donatit. S'është çashtja me i ba komente Kanunit: çashtja është, me perkthye tekstin ashtu si është. Flitet per teme teknike e legale: aq sa kà dijtë P. Shtjefni - dritë pasët! - në kso termesh, i din secili nesh - un do t'a dergoj nji listë

biblijotekash, qi sugurisht kishin me e blë Kanunit.

Më fal se s'po m'epet me shkue ma gjatë me ket leter: më ka kcyë damari me i a hi njëjë kangë të Lahutës sande, e s'kam si vijoj më gjatë. Por jo, prit; se kam edhe nji fjalë.

Kam kenë dy here në Postico, e të dyja herët kam ndëjë per nji ditë. Doga është shndosh e fort kondën. Me P. Martinin kam ba qi me i u njoftë per kohë ligjore të Probandatit muejt qi kà kaluë në Bari; e kshtu kà me u veshë Munëgëshë në muejt të Gushtit. Madre Maggiorë e don fort e kà urdhmue - posë ushqim me shoqë t'jera - me i dhënë kolacion posaçem në 10 paradite e merendë në 4 mbasditë. Mâ teper, per mos me e lënë me ba [...] kuvendi, e kam qitë si nji farë sekretarjet, me shkruë s'dij se shka... per Munëgëshë. Më kà thënë me i gjetë figurët pomen- dojë të veshunit të sajë e me i a ba gati epigrafën si edhe me i gjetë emnin e ri rregulltar. I kam shkruë edhe Vitores se është shndosh e kondën e se Murëgëshat kan kujdes të posaçem për; veç se nuk i kam shkruë gjà se veshet në Gusht. Kam me i shkruë Munëgëshat vetë. Në ftyrë është fort mà mirë se në Shkodër, e është fort kondën si të thoshe - Nji ditë e kishin qitë me lypë, pse kishite kerkuë vetë me dalë e jo pse e kam detw rue. Munëgëshat kan me më thirrë per vesticjon të sajë, edhë un do t'u shkoj - I kam premte Doga's, se do të perkthe per të n'at rasë të dytin liber të Kempis - Kam uzadajë në Zotin se Doga kà me ba buona riuçita.

Kallxoja edhë Madres kto sende; pse ajo është e mëçme e e don Dogen. Madres vetë kam me i shkruë, kur Doga të veshet Munëgëshë. Kish të mendojshin të gjitha si Madria në ket punë! Pse do të flitej pak e do të ndihej edhe mà pak! Sa per fjalë mjaft kà të motrat e veta. Vokacioni i cilles Munëgëshë shqyptare kà kenë vù mà fort gjatë

në provë se vokacioni i ksajë ma se prej shpjet, kù kà pasë nji mij të mira, mbas dymbdhetë vjet kundershtimesh kà hikë e është ndry në Kuvend! Nuk është mirë me shartue zi e me ba profecija jashta vendit. Edhë Ruth e Bersabë njiñen në genaologi të Krishtit. Mâ shjë e mà Shejtneshë se Krishti s'është kush i gjallë. Nejsë...

Si të thashë, kam fillue nji kangë, qi shpresoj se kà me mbetë nder mà të bukura të Lahutës. Dër m'sod kam shkruë ktu n'Itali katër kangë të Lahutës; nji Cantico drammatico mà se dy mij vjershash; nji Konferencë mbí Provincjen t'onë e nji satirë mjaft të gjatë. E pra Doktorit më kà pasë urdhmue kater muejt pushim menduer, posë trazimesh të mdhà qi më qesin letrat shum herë të papuna. I falem nderës Zotit, qi kà kthye në Shkodër t'i!

M'i thuej P. Palit se kilja e duhanit s'më kà rà në dorë. Me Postë nuk kam qef me më dergue kurrgjà duhan. Jam ngusht por s'kam shka baj. Nuk kà hije per mue me m'u gjetë gjà kontrabandë.

Por, se të m'a dergoj Fr. Ndou nji shishe rakì - të gjymtueme, merr vesh - kishite me m'u ba qefi; mjaft qi të jët aso s'meret. Më kà marrë malli per nji pike rakì Gjùhadolli!

Fal me shndet P. Antonit, P. Pashkos, P. Palit, Martinin, Franco Kirit, P. Jakut, P. Paulinit, Sebastjanit, Antoninit, Fr. Ndout, Ndoc Lisnes e Shtyshkrojsve, Zef Prendushit, Ndocit, Nanës s'ate etr. etr. Kam me të shkruë per së shpejti.

Mâ bash naten e mire, e kjo leter të gjetët shndosh!

P. Gj. Fishta
M'byten mushkajat, eh i marroftë Zoti!

Adresen po t'a shkruaj italisht,

pse ndryshe m'recapis Posta shkruen:

Fort i Nderti, e kurrgjà t'jetër.

"DITËT E KUJTESËS"

ISH-I PËRNDJËKURI RESHAT KRIPA: KUSH PASKA QENË FAJTOR PËR VUAJTJET TONA?



Reshat Kripa

Nën moton "Identiteti dhe Kujtesa" është çelur edicioni i tretë i aktivitetit "Ditët e Kujtesës". Organizuar nga Instituti për Demokraci Media dhe Kulturë (IDMC), partneriteti me fondacionin gjerman "Konrad Adenauer" (KAS) dhe aktorë të tjerë të fushës së kujtesës, ky aktivitet vijon 10 ditë duke synuar reflektimin mbi të shkuarën komuniste. Ambasadorë, zyrtarë të ndryshëm, ekspertë të historisë, ish-të përndjekur dhe nxënë të shkollave të Tiranës ndoqën hapjen e tij. Vëmendja shkoj të prezantimi i disidentit gjerman Karsten Dümmel, i cili tregoi të dhëna arkivore nga dosjet të STASI-t gjermano-lindor dhe mënyrën se si përndiqeshin njerëzit në kohën e komunizmit. Po kështu, ekspozita "Monitoro, Terrorizo, Persekuto" i dha të pranishmëve një idë më të qartë të aktivitetit të policisë sekrete të asaj periudhe. Hapja e "Ditëve të Kujtesës", u përhëndet nga drejtoresha e IDMC Jonila Godole, drejtori i KAS në Tiranë, Walter Glos, ambasadorja gjermane Susanne Schütz dhe ish-i përndjekuri Reshat Kripa. Godole tha se gjatë këtyre 28 viteve "për-

e reflektimit rreth së shkuarës dhe ndërgjegjësimit rreth krimeve të komunizmit. Drejtori i KAS, Walter Glos përmendi gjithashtu mungesën e vullnetit politik për t'u përballur me të shkuarën komuniste në Shqipëri. Ambasadorja gjermane Susanne Schütz, teksa përhëndeti aktivitetin, këmbënguli se "vetëm kush e di të shkuarën dhe përballet me të, e kanë të ardhme". Ish-i përndjekuri Reshat Kripa tregoi një pjesë të historisë së tij të vuajtjeve gjatë sistemit komunist dhe rikujtoi se "në këto 12 vite, pas miratimit të rezolutës që do të dënonte krimet e komunizmit nuk është bërë asgjë". Ai tha: "Të gjithë thërrasin 'jemi të pafajshëm', por atëherë kush paska qenë fajtor për vuajtjet tona (të të përndjekurve), mos vallë ishim vetë në fajtor për ato që na ndodhën?". Disidenti gjerman Karsten Dümmel teksta prezantoi mekanizmin e përndjekjes së STASI-t, thjeshtëzoi për të pranishmit me një shembull të qartë

punën e hapjes së dosjeve të ish-Republikës Demokratike të Gjermanisë. Ai tha se, "kur je i vogël, ke frikë nga errësira e qilarit poshtë dhe i qëndron larg, askush nuk shkon të shohë se çfarë po ndodh, pikërisht këtë pjesë bëjmë ne në Gjermani apo Rumani, shkojmë poshtë në qilar dhe ndriçojmë ato pjesë nga ku vjen kjo frikë në kuptimin e së shkuarës komuniste dhe të përndjekësve të saj". Për ta bërë edhe më konkret prezantimin e tij, historiani, anëtar i AIDSSH, Margleng Kasmi, tregoi shkurtime historikur e STASI-t dhe i ftoi më tej të pranishmit për të parë ekspozitën "Monitoro, Terrorizo, Persekuto". Ekspozita përbante të dhëna mbi aktivitetin e agjencisë sekrete të Gjermanisë Lindore bazuar në pesë tema kryesore: të rinjtë, udhëtimi, kultura, kisha dhe sporti, duke treguar se si STASI monitoronte dhe kontrollonte jetën e përditshme të popullit.

Opinion i Ditës

Hungari 1956, si vijoi historia...

Nga Përparim Kabo

(vijon nga faqja 1)

... u përdhos ëndrra e një populli, që i pari i çorri maskën imperialitetit sovjetik pas Luftës së Dytë Botërore. Përmes të dhënave muzeale, arshivave dhe dokumenteve në përdorim të gjerë apo atyre të klasifikuara është kreu dhe mundur që bollshëm të vjelësh njohuri, të gjes foto, gazeta dhe incizime të asaj periudhe. Studimet që ende vazhdojnë gjejnë argumente të reja, ripërqendrohen te fakte të njohura, që edhe mund të rridskutohen, si edhe të tillë të panjohur më parë që lipsin vëmendje dhe analiza të thella në ndërkallje me ato konstante të gjithëpranuara, por edhe duke u larguar atyre me qëllimin e frytshëm për nxjerrjen e përfundimeve të patakuara më herët. Është i njohur fakti që shqetësimi për situatën hungareze shkoi deri në OKB, por ndryshe u soll Imre Nagy e ndryshe Janosh Kadary. Në procedurë dhe nëpërmjet saj gjërat u shtyn në kohë sepse ngjarjet e njëkohshme që ndodhën në Kanalin e Suezit morën më shumë preokupim, në shumë vëmendje dhe më shumë angazhim institucional nga OKB-ja. Nuk e di a gjen sot arsye argumenti që u lëshua aso kohe, se ndërhyrja ushtarake nga perëndimi në mbrojtje të Hungarisë mund të shpinte në një luftë taktike me armë bërthamore me Bashkimin Sovjetik, që mund të shkatërronte botën. Frika në periudha historike, ngrihet shpesh edhe si argument e alibi e për rrjedhojë gjetend motivimi "se një e keqe e vogël është e pranueshme përball një fataliteti gjithëpërfshirës". Si shkruan autori hungarez, Béla K. Kiraly: "Në vitin 1956 forcat e armatosura tradicionale të Bashkimit Sovjetik tejkaluan ato të NATO-s. Ky superioritet e bëri mbrojtjen e kufirit lindor të territoreve të NATO-s të pamundur me mjete tradicionale. Një sulm sovjetik mund të ishte zbrapsur vetëm me armë bërthamore taktike, por shpërthimi i bombës së parë bërthamore taktike do të çonte në një luftë bërthamore dhe në fundin e civilizimit njerëzor. Ky fakt ishte argumenti më i fortë që nënvizonte politika e Perëndimit, duke shtyrë të gjitha konsideratat e tjera në sfond".¹

Në 27 tetor 1956 fuqitë perëndimore kishin parashikuar që situata në Hungari të shqyrtohej në Këshillin e Sigurimit të OKB-s. Imre Nagy kishte shpresuar se OKB-ja do të luante një rol të rëndësishëm për situatën në Hungari, ndaj për këtë qëllim ai e riktheu në atdhe Pëter Kós që ishte kryetari delegacionit i Republikës Hungareze pranë selisë së OKB-s. Vendin e tij e zuri János Szabo, një ish-deputet. Për fatin jo të mirë të popullit hungarez dhe luftëtarëve të lirisë, në dy ditët e fundit të atij tetori të largët tashmë, pra në 30-31 tetor 1956 trupat sovjetike e pushtuan Hungarinë.



Po në 31 tetor trupat ushtarake franceze dhe angleze shkuan në Suez dhe nisi bombardimi i Egjiptit. Në 1 dhe 2 nëntor, Imre Nagy me anë të një letre i kërkonte ndihmë Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-s zotit Dag Hammarskjöld, i cili në respekt të së vërtetës historike, duhet thënë se nuk ju përgjigj kësaj letre, si dhe nuk mori masa. Ai as që mori pjesë në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit në datat 2 dhe 3 nëntor ku do të diskutohet çështja hungareze. Duket si një neglizhencë që as në planin etik e më keq akoma as edhe në atë institucional nuk gjenin justifikim. Nga largësia e viteve mbase me mendje të kthjellët, në aktualisht mund të gjejnë një lloj motivimi duke hamendësuar se ai e dinte që ajo mbledhje nuk do zgjidhte gjë. Do të ishte thjesht një formalitet. Gjithçka ishte e vendosur të ndodhte duke mos e ndaluar. Ja, rrallëherë ngjarjet jashtë kontrollit krijojnë atë që njihet si historia e faktit të kryer, e për pasojë qëllimi përmblyllës është vënia në jetë e atij plani që kur nuk je në gjendje ta ndalosh. Diku mes debateve në fund të shterren energjitë, nuk të pranohen argumentet që në tavolinë janë të qartë dhe bindës, por që nuk përputhen me rrjedhat në fushën e betejës, ndaj edhe të thuhet: "Le të ndodhë, nuk mund ta ndalim". Dag Hjalmar Agne Carl Hammarskjöld (29 korrik 1905 - 18 shtator 1961) ishte ekonomist dhe diplomat suedez i cili shërbeu si Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Hammarskjöld ishte personi më i ri që e pati mbajtur postin, ishte në moshën 47-vjeçare kur u emërua. Mandati i tij i dytë u ndërpre fatalisht, pasi ai humbi jetën në një aksident me aeroplanin rrugës kur udhëtonte

për në Kongo, me qëllim për të ndaluar luftimet e për të krijuar mundësinë e negociatave mes palëve të përfshira në krizën e vendit afrikan. Ai është një nga katër personat që do të shpërblehesh me çmimin Nobel për vdekjes. Hammarskjöld është përmendur si një nga dy sekretarët më të mirë të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe emërimi i tij është vlerësuar si suksesi më i rëndësishëm për OKB-më. Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës John F. Kennedy e quajti Hammarskjöld "më i madhi". Ja përse mendoj se ky personalitet nuk mund të sillej me shpërfillje për çështjen hungareze. Nisur nga figura e tij zyrtare lihet të (mirë)kuptohet pse ai u soll në atë mënyrë. Kushedi se sa e ka brejtur ndërgjegjia. Ikja e beftë nga jeta dhe mungesa e kujtimeve personale e mbylli përfundimisht këtë çështje. Këshilli i Sigurimit, është fakt, që u shpreh se ishte kundër ndërhyrjes së forcave sovjetike në një vend të pavarur si Hungaria por; "asnjë rezolutë nuk u miratua për zgjidhjen". Situata e krijuar tronditi ndërgjegjen njerëzore dhe institucionale të këtij personi.

Zotë Hammarskjöld, si të thuash donte të hiqte qafe këtë përgjegjësi të pakëndshme, që e vendosi atë dhe zyren e tij në një konfrontim me Bashkimin Sovjetik. Kjo gjendje përgjegjësie dhe ankthi e shpuri në idenë se një komitet i veçantë dhe jo institucioni i Sekretarit të Përgjithshëm, duhet ta trajtonte problemin hungarez në OKB. Asambleja e Përgjithshme mori vendimin në datën 10 janar 1957 për ta ngritur atë. Komiteti kishte në përbërje përfaqësues nga Australia, Ceyloni, Danimarka, Tunizia dhe Uruguai. Personat

përfaqësues të këtyre shteteve që tashmë kishin një mandat të OKB-s morën edhe miratimin e qeverive respektive. Cilët ishin këta persona? Australia përfaqësohej nga zoti K.C.O. Shann, Ceyloni nga zoti R.S.S. Gunewardene, Danimarka nga zoti Alsing Andersen, Tunisia nga zoti Mongi Slim, Uruguai nga profesor Enrique Rodriguez Fabregat. Komiteti u ngarkua nga Asambleja e Përgjithshme me detyrën që t'i siguronte asamblesë dhe anëtarëve të Kombeve të Bashkuara, informacionin e plotë dhe të vlefshëm në lidhje me situatën e krijuar nga ndërhyrja e Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike, përmes përdorimit të forcës ushtarake dhe mjeteve të tjera në çështjet e brendshme të Hungarisë, si dhe në lidhje me zhvillimet që kishin të bënin me rekomandimet e Asamblesë për këtë çështje. Deri këtu zhvillimet ishin si të thuash brenda një normaliteti, veçse pikërisht në këto momente ndodhi diçka që befasoi. Qeveria hungareze ndaloi që Komiteti të kryente vëzhgime direkte në Hungari, si edhe kërkonte rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Një situatë gati paradoksale. Hungarezët me qindra mijëra që në palcën e dimrit e lanë atdheun dhe kaluan kufirin u trajtuan nga OKB-ja me një shpejtësi dhe korrektësi shembullore për akomodimin e tyre në disa vende në Europë dhe jashtë saj. U zgjdh me rregull si të thuash kriza e parë humanitare pas Luftës së Dytë Botërore. Ndërkohë që brenda Hungarisë arrestoheshin, burgoseshin dhe dënoheshin deri me humbjen e jetës qytetarë që kishin qenë luftëtarët e lirisë dhe antisovjetikë. Internoheshin qindra mijëra njerëz, madje edhe në

kampet sovjetike. Kjo situatë ku qeveria hungareze për të mbrojtur regjimin komunist po godiste popullin e vet i tha jo edhe Komitetit të ngritur nga OKB-ja. Në këto rrethana, pas një këqyrjeje të dokumenteve, komiteti vendosi të kryente seanca dëgjimi me dëshmitarë të ngjarjeve. Takimet me ta u caktuan të zhvilloheshin në selinë e OKB-s në Nju Jork. Edhe sot kur mendon qëndrimin e ngurtë dhe refuzues të ish-qeverisë hungareze të asaj kohe indinjohesh. Pala sovjetike me prezencën e ushtrisë dhe tankeve në rrugë si dhe zhgënjimi i madh që kishte pllakosur patën krijuar një gjendje të tillë të paqëndrueshmërisë institucionale, emotive dhe psikologjike në tërësi. Kemi të bëjmë në këto rrethana me një shoqëri tej mase të shqetësuar. Gjithsesi një vend anëtarë i OKB-s si Republika e Hungarisë nuk kish se si të bllokonte një institucion "ad hoc" si edhe qe ky komitet. Është të vërtetë se ajo qeveri turpërisht e konsideroi pushtimin si një çlirim dhe ndërhyrjen si një ndihmë e kërkuar, por edhe në këto rrethana të sajura dhe propagandistike, nuk mund t'i thuaj jo OKB-s. Është ky një nga veprimet e gabuara dhe të pashlyeshme në historinë institucionale dhe në raportet ndërkombëtare të qeverisë hungareze me institucionin më të lartë në rangun ndërkombëtar. Edhe i mbyllur dhe i izoluar po të vetëshpallesh dhe vetëgjatohesh, është e pamundur të fshihen të vërtetat, ngjarjet, bëmat, viktimat dhe pasojat e një ndeshje civile me armë më palëve dhe një ndërhyrje ushtarake me armë ndaj vendit tënd. Nga 11 marsi deri në 16 prill të vitit 1957, Komiteti punoi në Europë në zyrën e OKB në Gjenevë si dhe në Romë, Vjenë, Londër. Këto dëgjesa ndihuan thelbësisht për të kuptuar se çfarë kishte ndodhur dhe çfarë përfaqësonin ngjarjet që u zhvilluan me aq përshpejtim në Hungari. Materiali i përgatitur dhe nënshkruar nga raportet e paraqit nga Komiteti në takimin e vet të 58-tetë në 8 prill në Gjenevë. Pas kësaj, komiteti u kthye në Nju Jork për të mbyllur përgatitjen e raportit, i cili u pranua unanimisht nga të gjithë anëtarët në mbledhjen e mbajtur të premtën 7 qershorit të 1957-ës. Në shifra ekzakte Komiteti dëgjoi gjithsej 111 dëshmitarë të ngjarjeve, 35 u dëgjuan në Nju Jork, 21 në Gjenevë, 16 në Romë 13 në Vjenë dhe 9 në Londër. Gjeografia kaq e gjerë ka rëndësi të tërë vlerësuar dy aspekte, seriozitetin e komitetit dhe përhapjen në dy kontinente të atyre që për këtë Komitet ishin dëshmitarë e gjallë të ngjarjeve, por edhe viktimat e shtypjes së kryeritjes hungareze të vitit 1956 kundër pushtimit sovjetik, kundër regjimit diktatorial, për një Hungari neutrale dhe jo zonë e influencës sovjetike. Është me rëndësi të pohohet se tre dëshmitarët e parë që u dëgjuan në publik ishin zonja Anna Kéthly, ministere shteti në qeverinë e Imre Nagy-it; Gjeneral Major →

← Béla Király, komandanti ushtarak i qytetit të Budapestit dhe shefi komandës i Gardës Kombëtare gjatë kryengritjes hungareze si dhe József Kóvágo, kryetari Bashkisë së Budapestit gjatë viteve 1945-1947 si dhe sërisht gjatë ditëve 31 tetor deri në 4 nëntor të vitit 1956. Jo vetëm këta tre persona me peshë në jetën e vendit, por edhe shumë personalitete të tjerë kërkuar nga Komiteti një zgjerim të dëgjësës edhe me të tjerë, madje iu kërkuar Komitetit që në zbatim të rezolutës së Asamblesë së OKB-së, personat që do shpreheshin për ato ngjarje të dëgjoheshin edhe nga qeveritë e Belgjikës, Kanadasë, Danimarkës, Francës, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Qëllimi ishte ndërkombëtarizimi i çështjes dhe rritja e ndjeshmërisë në aspektin institucional. Jepeshin madje dhe rekomandime me emra se cilët persona do të ishte mirë të dëgjoheshin. Diku te 200 hungarezë i dërguan letra Komitetit dhe me iniciativën e tyre kërkoi të dëgjoheshin nga ai. Ngritja e kësaj vale e shtyu Komitetin që të respektonte këtë interesim, por njëherësh me qëllim përfitim sa më të madh dhe të gjerë, ai vendosi disa rregulla. Dëshmitarët e selektuar dhe klasifikuar, proces që u zhvillua nën drejtimin e kryetarit të këtij grupi reporterësh. Të parët që u konsideruan ishin ata që përpara Komitetit do të sillnin pohime që lidheshin direkt me ngjarjet si dhe me njohjen e gjithçkaje që kishte ndodhur në Hungari. Gjithashtu, u bë kujdes që dëshmitarët që do të dëgjoheshin të ishin nga të gjitha shtresat e shoqërisë hungareze dhe nga të gjitha zonat e Hungarisë. U mbajt në vëmendje që as të mos kishte diskriminim ndaj atyre që dëgjoheshin, por as edhe përsëritje. U dëgjuan me vëmendje një numër i madh punëtorësh nga industria e rëndë si dhe punonjës, që ishin treguar tejet aktivë me sindikatat. Shumë prej tyre kishin marrë pjesë në revoltë dhe përleshje me emrin e thjeshtë "Luftëtarët e Lirisë". Mes tyre që u dëgjuan kishte dhe nga ata që kishin qenë anëtarë të "Këshillit Revolucionar të Budapestit" si dhe të rretheve përfshi edhe ata që kishin qenë anëtarë të Komitetit të "Këshillit të Punëtorëve" të Csepel-it. Dëshmuar gjithashtu inxhinierë dhe teknikë si dhe drejtues të ndërmarrjeve shtetërore përfshirë edhe nga ata që kishin drejtuar minierën e uranimit në Pécs. U dëgjua edhe një numër relativisht i konsiderueshëm fshatarësh, që po huan për situatën në zonat e tyre, por u bë kujdes që të dëgjoheshin edhe punëtorë apo studentë që ishin me origjinë nga fshati. U dëgjuan pa dallim intelektualë komunistë dhe jokomunistë. Komiteti vlerësoi me interes dëgjësën me disa nga pjesëtarët e Klubit Petöfi, i famshëm dhe tejet aktiv në frymëzimin e ngjarjeve si dhe shumë personalitete të pavarur si gazetarë, artistë, arkitektë, profesorë të jurisprudençës, të mjekësisë, të filozofisë, të historisë, të shkencës, teknologjisë, ekonomisë, agrokulturës, si dhe disa jurist dhe prokurorë. U dëgjuan me respekt të veçantë studentët e universiteteve, vajza dhe djem dhe mes tyre dhe ata që kishin drejtuar "Këshillat Studentore". U dëgjuan shumë ushtarakë nga të gjitha rangjet, që nga ushtarë të thjeshtë deri te drejtues të lartë si psh., nënkomandanti i përgjithshëm i Gardës Kombëtare të Csepelit dhe

Komandanti i qendrës Corvin, Komandanti i forcave revolucionare të jugut të Hungarisë si dhe udhëheqësi i "Luftëtarëve të Lirisë" dhe forcave guerilje në jug-perëndim të Hungarisë. Ishin shumë të vlefshme rrëfimet dhe pohimet e mjekëve dhe infermierëve që kishin shërbyer ndaj të plagosurve dhe nën kujdesin e Kryqit Kuq ishin marrë me transportimin e tyre. Dëshmi u morën gjithashtu nga një numër i konsiderueshëm zyrtarësh pranë qeverisë, përfshirë edhe diplomat, disa prej tyre



edhe të rangut të lartë. Komiteti dëgjoji dhe njerëz të fesë pa dallim katolik, protestant dhe hebrej. Nuk u lanë pa pyetur dhe ish-anëtarë të parlamentit, shumë prej të cilëve vinin nga Partia Komuniste apo që kishin qenë formalisht të tillë, nga Partia Social Demokratike dhe nga Partia e Pronarëve të Vegjël të Pavarur. U dëgjuan pacifistit, të cilët në trysnin e zhvillimit të ngjarjeve i braktisën parimet dhe u përfshinë në luftimet e zhvilluara. Shumë nga dëshmitarët e dëgjuar kishin kaluar vite në burg për shkak të qëndrimit kundra Horthy dhe kundra nazizmit, por që për ironi kishin kaluar vite burgu edhe në regjimin komunist.² Është kuptimplot fakti që u dëgjua edhe një person që kishte qenë stenograf i policisë sekrete. (Ëllamvëdelmi Hatóság, që më vonë u njoh si ÁVH) Në prag të ngjarjeve pati nga ata që disa javë më parë e patën lënë Hungarinë por hynin e dilnin për të nxjerrë jashtë familjarë apo miq. Komiteti pyeti edhe disa prej tyre. Shumë ikën se e ndjenin se mund të arrestoheshin. Pati edhe nga ata që u arratisën nga treni që po i çonte në Bashkimin Sovjetik. Shumë ja mbathën se kishin kuptuar se apartamentet ku ata banonin ishin nën mbikëqyrje, ose kishin kuptuar se duke qenë anëtarë të Këshillave Revolucionare të Punëtorëve, mund të arrestoheshin, si edhe kishte ndodhur me një numër kolegësh të tyre. Duhet të përmendim se pjesa më e madhe e dëshmuësve ishin nën 35 vjeç. Shumë ishin edhe të rinj fare, madje edhe disa 16-vjeçarë. Dëshmitë të rinjve e tronditën thellë Komitetin. Dëgjime të hapura pati edhe në prani të mediave, por shumica u bënë të mbyllura për të mos rrez-

ikuar familjet e atyre që dëshmonin. Në të gjitha rastet pati një protokoll strikt për gjithkënd që dëshmonte. Fillimisht merreshin gjeneralitetet, shtasi si dhe sugjerohet që gjithçka thuhej të ishte e orientuar nga eksperiencia personale e përtjetuar. Kishte nga ata që firmosnin edhe dokumente të rëndësishme apo drafte origjinale për atë që lidhej me dëshminë e lëshuar prej tyre. Kështu që komiteti përgatiti një dosje me rreth 2000 faqe. Kujdesi procedural ishte që dëshmitë të ishin në bash-

Përgjigja e palës hungareze e datë 25 mars 1957 ishte po ajo, refuzuese. Kështu u soll madje dhe qeveria rumune kur iu kërkuar që Komiteti të takonte Imre Nagy-n, që kishte kaluar dhe ndodhej atje. Sërisht standardi cinik erdhi si refren se bihet ndesh me shpirtin e Kartës së Kombeve të Bashkuara. Në fakt, Komiteti u tregua tejet i kujdesshëm që të respektonte vetëm kërkesat që buronin nga detyra që i kishte ngarkuar Asambleja e Përgjithshme. Komiteti vuri në dukje në raportin e tij të ndërm-

jetëm se shqetësimi kryesor i tij ishte: "Të konstatohej shtrirja dhe ndikimi i ndërhyrjes së huaj, nga kërcënimet ose përdorimi i forcës së armatosur ose mjeteve të tjera në çështjet ndërkombëtare dhe pavarësinë politike të Hungarisë dhe të drejtat e popullit hungarez". Kishim të bënim me një pushtim të hapur. Se çfarë ndodhi më tej, këtë do e lexoni në tetorin e ardhshëm, por një gjë duhet thënë me zë të plotë, ky Komitet dhe puna e tij serioze zbardhi ngjarjet, situatën, shkaqet dhe pasojat; ndihmoi jo thjesht OKB-në, por historinë. Në ditët tona ka shumë ngjarje në vende të ndryshme anë e mbanë botës që humbasin dhe e vërteta për to nuk mësohet pikërisht se nuk ka një interesim të tillë skrupuloz. Historitë e fshehura janë historitë më të rrezikshme. Historitë e njohura sado tronditëse të jenë, kur dalin në dritë të diellit shndërrohen në më pak të rrezikshme, sepse vetëdija njerëzore dhe ajo institucionale nuk lejojnë që ato të përsëriten. Tetori hungarez i 1956-ës, të cilit i rikthehem çdo vit më mëson shumë. Mbasesh ndodh që ëndrrat e parakohshme kur janë lëvizje shoqërore shtrojnë rrugët ku do të kalojë e ardhmja. Faleminderit popullit hungarez!

(Footnotes)
¹ 1956 The Hungarian Revolution and War for Independence, page 513.
² Ky fenomen takohet edhe në historinë e vendit tonë, Petro Marko u dënua nga fashistët si anti-fashistë, por edhe nga komunistët si antikomunist pa çka se kishte qenë edhe luftëtar në Spanjë dhe në Luftën Nacional Çlirimtare. Me sa duket regjimet nuk i durojnë dot njerëzit e lirë.

HOROSKOPI

DASHI

Vullneti juaj do të vlerësohet sot. Mos e humbni qetësinë, teksa do të duhet të ndërmerri një vendim shumë të rëndësishëm. Të ardhurat financiare do t'ju përmirësohen, por ndërkohë edhe shpenzimet do t'ju rriten. Mos u sillni kokullur në marrëdhënien tuaj të dashurisë.

DEMI

Sot do të keni kohë mjaftueshëm për t'ia kushtuar vetes. Bëni më shumë kujdes për shëndetin. Do të kaloni një ditë fantastike sa i përket lidhjes suaj romantike. Mos u përfshini në bashkëpunim dy palësh në biznes, pasi do të dilni humbës.

BINJAKET

Bëni kujdes me dietën dhe përpikuni të kryeni sa më shumë aktivitet fizik. Bashkëshorti/bashkëshortja dhe fëmijët do t'ju kushtojnë vëmendje të veçantë. Mos u shoqëroni me persona që përpigjen të shkatërrojnë reputacionin tuaj.

GAFORJA

Përpikuni të kujdeseni më shumë për veten tuaj. Është koha e duhur të kontrolloni peshën trupore dhe të nisni ushtrimet fizike. Parashikohet se do të keni rritje të të ardhurave, për shkak të investimeve të mëparshme.

LUANI

Do të kaloni një ditë ku do të dominojë buzëqeshja. Do të fitoni para mjaftueshëm, por bëni kujdes me blerjet e mëdha. Sot do të kuptoni se dashuria zëvendëson gjithçka. Edhe pse do të përballeni me kundërshtime në punë, mos u dorëzoni dhe ruani qetësinë.

VIRGJERESHA

Do të kaloni një ditë plot argëtim dhe humor. Përpikuni të kontrolloni fjalët dhe të mos lëndoni njerëzit rreth jush. Ka gjasa që sot të takoni njeriun e zemrës. Familja do të luajë një rol shumë të rëndësishëm në suksesin tënd, sidomos femrat e familjes.

PESHORJA

Bëni kujdes që të mos tregoheni neglizhent, pasi do t'ju shkaktojë probleme në vijim. Në punë do të kaloni një ditë shumë të mirë, pasi gjithçka do t'ju shkojë ashtu siç doni. Sa i përket anës romantike, është ditua juaj me fat.

AKREPI

Mendohuni mirë para se të merrni një vendim të rëndësishëm për të investuar atje ku keni kohë që e planifikoni. Bashkëshorti/bashkëshortja juaj do të tregohet shumë bashkëpunues, pavarësisht sjelljes suaj të çuditshme. Mbeshtësitja e kolegëve do t'ua ngrejë moralin.

SHIGJETARI

Do të vlerësoni një mikun tuaj për suksesin e arritur. Do të fitoni para sot, por për shkak të rritjes së shpenzimeve do ta keni të vështirë të kurseni. Mund të merrni një lajm që do t'ju lumturtojë pamasë.

BRICJAPI

Sot do të ndihni shumë mirë nga ana shëndetësore. Përpikuni të mos shijoni vetëm momentin, por mendoni më gjatë. Sot do të përjetoni emocione të shumta në dashuri dhe do të kuptoni se kjo ndjenjë nuk ka kufij.

UJORI

Duhet të përfshihen më shumë në çështje familjare dhe të merrni përgjegjësitë që i takojnë. Personat e kësaj shenje që punojnë në sektorin bankar do të marrin një lajm të mirë.

PESHQIT

Do të ndihni mirë nga ana shëndetësore, pavarësisht se do të kaloni një ditë të lodhshme. Është koha e duhur të ndryshoni natyrën tuaj dominuese. Punoni ngushtë me ata që ndajnë me ju vlljet dhe ngritjen. Një miqësi e ngushtë mund t'ju ketheft në romancë.

Në Champions dominojnë gjigantët

Kryendeshja e mbrëmjes, Juventusit thyen Mançesterin në "Old Trafford"



gjitha për Juventusin, që sulmoi që nga minuta e parë për të kërkuar një rezultat që do të përfordonte

Juventusit konfirmohet si pretendente për të fituar Ligën e Kampionëve pasi ka provuar sot se mund të fitojë edhe në një fushë të vështirë si ajo e Mançester Junajtidi. Në suksesin e sotëm 1-0 në Angli, bardhezinjtë bënë thujtje formalitet kualifikimin, të cilin mund ta sigurojnë që në ndeshjen e ardhshme. Pjesa e parë foli e

pozitat në kreun e grupit. Goli i shpejtë erdhi falë një shpërthimi të Ronaldos në krahun e djathtë dhe një gjuajtje të Kuadros të devijuar nga De Gea. Sfera përfundoi te Dibala, i cili pak hapa larg portës nuk e kishte të vështirë të dërgonte topin në rrjetë. Dominimi i Juventusit vazhdoi gjatë gjithë pjesës së parë, me bardhezinjtë që krijuan edhe disa mundë-

si të tjera shënimi. De Gea u tregua i jashtëzakonshëm ndaj Ronaldos edhe në fillimin e pjesës së dytë, në një episod që duket se zgjoi Junajtidin, i cili kërkoi me forcë të ndryshonte rrjedhën e ndeshjes. Anglezët filluan të shtynin gjithnjë e më shumë drejt portës kundërshtare dhe rrezikuan disa herë katërkëndorin e Shzesnit. Më afër golit iu afrua Pog-

ba, pasi goditi shtyllën e më pas një devijim me fat i portierit të Juventusit bëri që sfera të mos përfundonte në rrjetë. Presingu i Mançester Junajtidi vazhdoi deri në vërshtëllimën përfundimtare, por italianët administruan mirë rezultatit dhe dolën nga stadiumi me tri pikë që i bëjnë liderë të padiskutueshëm të grupit me pikë të plota pas tre ndeshjeve.

SUPERLIGA	
TË MARTEN	
GRUPI E	
AEK - Bayern Mynih	0-2
Ajaks - Benfika	1-0
GRUPI F	
Hofenheim - Lion	3-3
Shakhtar - Man.Siti	0-3
GRUPI G	
Real Madrid - Viktoria	2-1
Roma - CSKA Moske	3-0
GRUPI H	
Jang Boiz - Valencia	1-1
Man.Junajtid - Juventus	0-1
TË MERKUREN	
GRUPI A	
Klub Bryzh - Monako	18:55
Borusia - Atletiko Madrid	21:00
GRUPI B	
PSV - Tottenham	18:55
Barcelona - Inter	21:00
GRUPI C	
Liverpul - Crvena Zvezda	21:00
Paris Sën Zhërmen - Napoli	21:00
GRUPI D	
Gallatasaraj - Schalke	21:00
Lokomotiv Moska - Porto	21:00

Verilindorët, pas dy humbjeve radhazi me kryesueset, arritën të gjejnë fitoren ndaj Kastriotit

Shameti: Mposhtim Laçin dhe rikuperojmë me kreun

Kapiteni i Kukësit i ka idetë e qarta



Jeton Selimi

Ndeshja me Kastriotin riktheu Kukësin te fitorja duke e lejuar të mos humbasë më tepër terren me kreun e klasifikimit. Një sukses i arritur jo thjeshtë dhe me përmbyse, por që ka vlera sidomos në aspektin e moralit për të hedhur pas dhe një periudhë jo të thjeshtë për verilindorët, sipas kapitenit Ylli Shameti. "Pas dy ndeshjeve jo shumë të mira, veçanërisht për shkak të rezultatit, kishte ardhur momenti që të merrnim 3 pikët, për të rigjetur qetësinë dhe për të vijuar rrugën drejt synimeve tona. Shpresoj që kjo fitore të na shërbejë për të vijuar rrugën tonë drejt suksesit", deklaroi Shameti për "Supersport". Mbrojtësi ishte heroi i ndeshjes me Kastriotin me një gol dhe një asist, një ndjesi e veçantë për 34-vjeçarin, aq më tepër që puna e tij u shpërblje dhe me suksesin e ekipit. "Pa



diskutim që është diçka e bukur dhe për më tepër kur merr fitore në transfer-

të. Janë momente ku kemi pasur edhe një farë ngërçi në sulm dhe shpresoj që

tani të na shkojë mirë", -tha mbrojtësi gjirokastriot. Përballë këtë fundjavë do

të jetë Laçi, me të cilin Kukësi barazoi 1-1 në ndeshjen e parë. Një kundërshtar i fortë, sfida ndaj të cilëve deri diku është shndërruar dhe në një lloj derbi vitet e fundit. Për Shametin e rëndësishme për ekipin është që skuadra nga tani e mëtej të ketë vazhdimësi dhe të mos bazohet dhe humbja e fundit e kurbinasve për të gjykur rivalët në mënyrë të nxituar. "Të gjitha ndeshjet janë shumë të vështira në këtë kampionat. Me Laçin kanë qenë si derbi përballjet tona dhe ata janë një skuadër simpatike, ku vrapojnë të gjithë, si në sulm, ashtu edhe në mbrojtje. Nuk duhet të

nisemi nga humbja e fundit e tyre, pasi ata luajnë në shtëpi dhe duhet të mobilizohemi maksimalisht për të marrë 3 pikët", tha Shameti. Diferenca me Partizanin kryesues nuk e tremb kapitenin e Kukësit, pasi për të kampionati është ende i gjatë dhe titulli nuk fitohet në vetëm një fazë. "Kemi kohë sa të duash për të rikuperuar. Ne thjesht duhet të bëjmë detyrën dhe të marrim ndeshjet me radhë, duke filluar që nga sfida me Laçin, ku na duhen 3 pikët. Nëse bëjmë këtë dhe ia dalim me sukses, nuk ka rëndësi sa pikë para është rivali ynë", -u shpreh Ylli Shameti.

LIDERI I LEGA NORD

Salvini: Donaruma të shkojë të luajë me të rinjtë

Ministrit italian të punëve vetë brendshme, Mateo Salvini, nuk i del e keqja me portierin Khanluixhi Donaruma të Milanit. Ai është një tifoz i thekur i kuqezinjve dhe nuk e ka përtytur dot atë humbje në kohën shtesë në derbin me Interin, ndaj dhe e ka sulmuar ashpër portierin Donaruma: "Do ta ulja menjëherë në stol, madje do ta çoja te skuadra e të rinjve. Nëse e humb derbin në minutën e 92-të për një lajthitje të kësaj natyre, për mua nuk mund të luash në 10 ndeshjet e ardhshme. Mua më pëlqen Gatuza, por nëse ekipi luan kështu... Kur zbrer në fushë dhe për 2/3-at e kohës mendon vetëm për të mos humbur, për mua je tashmë i humbur. Derbin duhet ta luash gjithmonë për të fituar, deri në sekondën e fundit", - ka thënë Salvini



Ish-kapiteni kuqezi vlerëson gardianin

Cana: Strakosha, një prej 5 më të mirëve në Europë

Ish-kapiteni i përfaqësueses shqiptare, Lorik Cana, mendon se Thomas Strakosha është një prej garancive më të mëdha që ka Lacio për të tashmen dhe për të ardhmen. Duke folur për një radio italiane, Cana ka analizuar ndeshjen mes dy ish-skuadrave të tij, Lacios dhe Olimpikut të Marsejës në Ligën e Kampionëve, duke u ndalur pak te paraqitjet e portierit kuqezi. "Tomi është një prej portierëve më të rinj që janë në skenën e futbollit evropian. Sigurisht që të kesh mundësinë në moshën e tij të jesh titullar, të kesh be-




simin e të gjithë ambientit, skuadrës, drejtuesve, gjithë klubit, është një fat i jashtëzakonshëm. Padyshim,

nuk mendoj se ia ka vjedhur ndokujt. Ai është një djalë që më kujtohet që kur erdhi në Formelo në 2012 dhe që jetonte për futbollin, jeton edhe tani për futbollin. Ka një baba, i cili mundohet ta ndihmojë me eksperiencën që ka. Normalisht çdo pritshmëri për të është e bazuar. Por ndodh që kur je në një klub të madh dhe në një moment të caktuar bën më pak mirë, sigurisht që vijnë edhe kritikët. Kjo është pjesë e bagazhit të tij dhe ai do të mësojë. Megjithatë mendoj

se klubi është me fat që ka një portier të atij niveli dhe mendoj se është për moshën e tij një prej 5 portierëve më të fortë në Europë. Ambienti duhet ta mbrojë shumë, ai e di që ka besim e të gjithëve dhe di që mund të luajë pa presion. Mendoj se ka bërë mjaft mirë deri tani. Nëse skuadra arrin katërshe, mendoj se edhe ai do jetë pjesë e suksesit dhe do të vazhdojë kështu edhe në të ardhmen për shumë vite", ishte parashikimi i Canës.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Robbins aktor
7. Thyhet me du kafshata.
10. Gjysma e ekipit.
11. Janë me këmbë në tokë.
15. Kalime në ekstremen.
16. Qe fallxhor i famshëm.
17. Inicialet e Moravia, shkrimtar.
19. Qe artizan i lirë në Greqinë e lashtë.
21. Njëlljo për latinët.
22. Famëkeqi Capone.
23. Ndezur në aparturë.
24. Ruajnë pa ujë.
26. Para de Janeiro
28. Markë pistolette.
29. Një Baba përrallor.
30. Rasti kur s'është ai.
32. Piktori i Naná.
34. Gjysmë sahati.

35. Qe biri i Amalasantas.
37. Fillojnë takimin.
38. Ndalim në kufij.
39. Të fundit në tender.
41. Janë si zana.
43. Inicialet e Lattuada regjisor.
44. Ai i bardhë është David Bowie.
46. Janë në qendër.
47. Mbyllin portat.
48. Eshhtë edhe ai baribal.
49. Angot e Lecocq.

VERTIKAL

1. Janë provat që thyhen në mikrofon.
2. Nofka e Eisenhower.
3. Fillojnë mirë.
4. Kaçaturian kompozitor.
5. Alan J. që qe regjisor.
6. Janë qen të egër Australisë.
7. Kutia kur nuk ka.
8. Mbyllin një dritare.
9. Ai dhe ajo.
12. Kazan i Baby doll.
13. Një pjesë e lartësisë.
14. Kundërfigura e... Tom Cruise.
16. Ajo e forcës është për të cmendur.
18. Shpirti i madh i lëkurëkuqve.
19. Thonë se kanë të gjithë një turi.
20. Eshhtë shtet aziatik.
25. Prodani që qe komik.
27. Kufijtë e Orientit.
31. Jessica Parker aktore
33. Salacrou i Boulevard Durand.
36. Zef komik shkodran.
40. Me të mund të nxjerrin trutë.
42. Padia pa ekstreme.
45. Dy asa në dorë.
46. Binjakët në klasa.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Famëkeqi Capone.
3. Gjysma e mamive.
6. Në mes të Edgar dhe Poe.
12. Ikja e... hebrejve.
15. Mbahet njëri pas tjetrit.
16. Gustav, kompozitor i famshëm.
17. Ekstreme në trotuar.
18. Fillojnë llogarinë.
19. Kështu ishin gladiatorët.
22. Eshhtë lloj ban.
23. Eshhtë edhe ai polar.
26. Ajo e të sëmurit është në kartotekë.
28. Ishte 1, anija kozmike e Jurij Gagarin.
30. Me të nxjerrin një tavë.
31. Masat pa ekstreme.
32. Blanchett aktore.
33. Një pikë në ligj.
35. Janë në qendër.
36. Një fjalë... goxha e madhe.

VERTIKAL


2. Modulli i Neil Armstrong.
3. U shkrua nga Daniel Defoe.
4. Toka e Dumond D'Urville në... Australi.
5. Josa trainer.
6. Kërkojnë takent të tilla.
7. Thirrje Ridolini në Itali.
8. Lind në kufij.
9. Eshhtë pemë.
10. Në mes të një kanali.
11. Janë shpendë lagune.
13. Ka shirit magnetik me... këngë.
14. Janë letrat... zyrtare.
20. Antonio, kompozitor i Katër sinët.
21. Nichols regjisor.
22. Në krye të trupave.
24. Luhet në ekstreme.
25. Të parat në lojë.
27. Përsëhëndëja e gladiatorëve.
29. Total pa kufij.
32. Orff i Carmina burana.
34. Në krye të rotarëve.
37. Eshhtë nusja me vello.
38. Fillojnë tani.
40. Damon aktor.
43. Ishulli i Kolosit.
45. Tre asa.
47. Norma e Martin Ritt.
49. ... poetica shkruar nga Horaci.
51. Ekstreme në stacion.
52. Mister i shkurter.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	G	U	N	A	I	F	A	P	E	L				
P	R	A	A	R	O	M	E	E	R	E				
A	M	A	N	D	A	R	O	M	E	B				
R	E	N	D	I	D	E	N	I	M	T	O			
A	R	I	E	K	A	M	E	R	A	M	A			
T	A	H	O	K	A	T	A	R	E	T				
I	O	K	A	P	O	T	A	T	O	M				
R	E	I	R	U	T	R	A	L	A	M	I			
N	E	N	T	O	K	A	A	L	A	I	N			
A	R	A	L	D	B	E	S	N	I	K	U			
T	O	R	D	D	O	N	I	D	E	T				
A	N	N	A	M	O	R	G	A	N	A				
K	A	N	D	I	D	A	T	N	U	R	S			
T	E	R	R	E	N	S	O	R	R	A	T			
N	A	T	A	K	D	I	T	A	V	A				
I	M	A	M	O	N	U	M	E	N	T	E			
T	I	M	P	A	R	A	N	G	R	A	M	A	L	E
V	A	L	K	A	Z	A	N	E	T	S				
K	O	M	I	T	E	T	I	K	A					
I	K	O	N	A	T	A	D	A	L	I				
I	N	A	T	E	T	A	A	N	T	E	U			
M	A	L	O	R	V	R	A	S	J	E	T			
A	T	R	I	T	E	T	M	O	T	E	R			
M	T	E	A	T	R	I	A	I	T	I				

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOK

8	1		7	4				
2		3					7	1
7		5		3				
			6				3	4
			2	8			9	
			9	5	7	2	6	
9			2	6	8	3		7
	6	4					9	2
					1			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	6	2	5	3	7	8	9	1
9	3	7	1	4	8	2	5	6
8	5	1	6	9	2	3	7	4
5	1	9	7	8	4	6	2	3
7	8	3	9	2	6	4	1	5
2	4	6	3	1	5	7	8	9
1	7	8	4	6	9	5	3	2
3	2	4	8	5	1	9	6	7
6	9	5	2	7	3	1	4	8

Argëtim filozofik

- Njihje veten? Nëse do ta njihja veten, do t'ia mbatjha me të katra. Mos o Zot që ta njih.
- Dëgjoji bindjet e të gjithëve, por dyshimet e tua mbaj për vete.
- Nëse fillon të mendosh për gjendjen tënde fizike apo morale, zakonisht e gjen se je i sëmurë.
- Në fushën e ideve çdo gjë varet nga entuziazmi... në botën reale gjithçka qëndron mbi këmbënguljen.



KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

5	1	14	4		19	6	8	5	3	4	1	4
1	2	8	1	5		8	4	7	10	6	4	3
14	6	7		2	7		11	6	2	1	4	
4	7		15	1	12	1	2	3	4		10	1
1		12	1	4	3	2	6	4	3		1	2
4	2	6	11	3	2	6	4	3		1	14	3
1	2	4	16	2	7	16	6		18	1	4	4
1	2	8	3	14			3	1		1		
1		6		4		11	3	4	2	6		15
8	1		4		18	6	2	1	4	3	2	6
19	16	1	10	6	4	3	4	6		3	2	R
10	3		15	6	10	6			14	19	16	5

I	T									K	A	D	E	T	I
D	I	F		D	M	A	K	E	T	E	T	E	T		
E	P	I	T	E	T	E				A	R	E	N	A	
M	I	N	I	M	A	L	E								
		A	P	O	K	A	L	I	P	S	I				
M	I	L	A	N	I	S	T	E	T	T	A				
T	R	I	R	E	M	A	T	T	A	K					
K	A	S	E	T	E	A	U	D	L	T					
		T	T	T	E	R	R	E	N	I					
A	D	E	T	K	R	I	S	M	A	T					
L	A	M	A	R	I	A	M	N	E						
T	S	T	R	I	P	T	E	A	S	E					

- - Më mirë të mashtrrohesh nga miqtë se t'i mashtrosh ata.
- - Secili ta pastrojë derën e vet dhe e gjithë bota do të jetë e pastër.
- - Disa njerëz nuk kujdesen për paratë e tyre derisa iu mbarohen, të tjerët bëjnë të njëjtën gjë me kohën e tyre.
- - Asgjë nuk është më e vlefshme se dita e sotme.
- - Pasionet janë vese ose virtyte në kulmet më të mëdha të fuqisë së tyre.
- - Burracakët kërcënojnë vetëm kur janë të sigurtë.

Thënie të mençura

